VENDIM
Nr.526, datë 20.12.1958

PËR NDARJEN E PUNËVE NË KATEGORI PËR EFEKT PENSIONI

(Ndryshuar me vendime të KM nr.54, datë 5.10.1966; nr.63, datë 4.4.1974; nr.58, datë 21.2.1976; nr.273, datë 19.8.1977; nr.79, datë 28.5.1979; nr.56, datë 23.3.1978; nr.181, datë 20.5.1980; nr.254, datë 3.7.1980; nr.342, datë 29.8.1980; nr.461, datë 11.11.1980; nr.78, datë 10.3.1981; nr.447, datë 28.10.1981; nr.288, datë 15.10.1982; nr.16, datë 8.1.1983; nr.49, datë 8.2.1985; nr.317, datë 9.9.1986; nr.446, datë 19.12.1986; nr.186, datë 30.5.1987; nr.479 datë, 18.12.1987; nr.195, datë 29.5.1989; nr.36, datë 9.2.1990; nr.130, datë 25.4.1990; nr.302, datë 27.8.1990; nr.305, datë 27.8.1990; nr.394, datë 17.11.1990; nr.421, datë 10.12.1990; nr.423, datë 10.12.1990; nr.34, datë 22.1.1991; nr.244, datë 23.7.1991; nr.317, datë 2.9.1991; nr.468, datë 24.12.1991; nr.138, datë 6.3.1993; nr.122, datë 6.3.1993; nr.209, datë 6.3.1993)
(Ndryshuar me udhëzim të KM nr.4, datë 2.12.1987)
(Ndryshuar me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë nr.1, datë 11.8.1986; nr.2, datë 8.6.1987; nr.l, datë 3.7.1989; nr.2, datë 7.9.1989; nr.3, datë 23.4.1988; nr.3, datë 26.4.1990; nr.4, datë 14.7.1990; nr.5, datë 24.7.1990; nr.6, datë 25.10.1990; nr.7, datë 25.10.1990; nr.8, datë 23.12.1990; nr.9, datë 24.5.1991; nr.10, datë 24.5.1991)

1. Punë të kategorisë I dhe të kategorisë II, për efekte pensioni quhen llojet e punëve që përshkruhen respektivisht në pasqyrat nr.1 dhe nr.2, që bashkëngjiten si pjesë të pandara të këtij vendimi.
2. Lloji i punës që punëtori ose nëpunësi ka kryer dhe vjetërsia në atë punë vërtetohen me anën e librezës së punës.
3. Drejtuesit e ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave janë të detyruar, nën përgjegjësinë e tyre, të shënojnë rregullisht në librezën e punës në mënyrë të përpiktë, llojin e punës, duke pasur parasysh emërtimin e punëve që përfshihen në kategorinë I dhe në kategorinë II.
4. Kategoritë e punëve sipas këtij vendimi zbatohen edhe për punët e kryera para hyrjes së tij në fuqi, por vetëm kur e drejta për pension ka lindur pas datës 31dhjetor 1958.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH	SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Mehmet Shehu	**Spiro Rusha**

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 31.12.1958

PASQYRA NR.1 E PUNËVE QË HYJNË NË KATEGORINË E PARË

Punë që hyjnë në kategorinë I quhen:

I. Puna në minera nëntokë (dhe) në punimet e tjera në nëntokë. Si punë e kryer në minierë nëntokë dhe në punime të tjera të nëntokës quhet puna e punëtorit e kryer gjatë gjithë ditës në miniera në nëntokë ose në punime të tjera të nëntokës si:

1. Minator në nëntokë;
2. Armator në nëntokë;
3. Vagonist dhe transportues me skrepër në nëntokë;
4. Zjarrmëtar në nëntokë;
5. Makinist i sharrave prerëse në nëntokë;
6. Transportierist në nëntokë;
7. Elektrovozist në nëntokë;

8. Pompist i brendshëm në nëntokë;
9. Turbist në nëntokë;
10. Arganist në nëntokë;
11. Shinashtrues në nëntokë;
12. Punëtor i shërbimit gjeologjik në nëntokë;
13. Sondist në nëntokë;
14. Punëtor i shpimit në nëntokë;
15. Punëtor i thjeshtë që punon në nëntokë;
16. Matës i gazit në nëntokë;
17. Karpentjer në nëntokë;
18. Manovrues i makinerive dhe mekanizmave; shpuese, ngarkuese, shkarkuese, ngritëse, gërryese dhe transportuese, që punon vazhdimisht në nëntokë.

Me punën e mësipërme barazohet edhe puna e inxhinierëve, teknikëve, brigadierëve, përgjegjës edhe zëvendësve të reparteve ose të turneve në nëntokë, kur ajo kryhet gjatë gjithë ditës në miniera në nëntokë ose në punime të tjera të nëntokës.

Si punë e tillë quhet edhe puna e kryer në sipërfaqe nga punëtorët dhe personat e tjerë të lartpërmendur për shkak të ndërprerjes së punimeve në miniera nëntoke ose në punime të tjera nëntoke, me kusht që një punë e tillë të mos zgjatë më tepër se 26 ditë pune.

II. PUNA NË AVIACIONIN CIVIL

Punë e tillë quhet puna e kryer si:
1. Komandant aeroplani;
2. Pilot;
3. Navigator;
4. Mekanik;
5. Radiotelegrafist;
6. Radiotelefonist.

III. PUNA NË FABRIKAT E PASURIMIT TË MINIERAVE TË BAKRIT, KROMIT, FONDERITË, SI DHE NË IMPIANTIN E PASURIMIT TË RËRAVE BREGDETARE DHE NË FABRIKËN E PASURIMIT TË KUARCIT

Punë e tillë quhet puna e kryer si:
1. Punëtor furre ose ndihmës i tij.
2. Punëtor shkrirjeje dhe derdhjeje të metalit, si dhe i pasurimit të mineraleve, si:

1) Punëtor i thyesit konik, i thyesit me nofulla, i sitës vibruese dhe i transportierëve kur këta punojnë në repartin e thyerjes, si dhe brigadier i këtij reparti;

2) Punëtor i bluarjes dhe i klasifikatorit kur këta punojnë në repartin e bluarjes, si dhe brigadier i këtij reparti;

3) Punëtor ushqyes, transportues dhe brigadier i repartit të ushqyesve dhe i repartit të transportuesave;

4) Punëtor flotues, i përgatitjes së qumështit, të gëlqeres, i vakum filtrave, i makinave të sedimentit, i tavolinave të koncentrimit, i elektromanjetëve, i furrave të tharjes i dambës i dekantorëve në pultet e komandimit, i pompave të shllamit, i baterive hidrociklonesh, si dhe brigadierët e reparteve përkatëse të këtyre punëve;

5) Marrës e përgatitës kampioni që punon në repartet e sipërme, si dhe vinçier që punon brenda në repart;

6) Punëtor të mirëmbajtjes dhe remontit.

3. Fugist;
4. Punëtor i derdhjes së metalit të shkrirë në konkilje;
5. Punëtor i transportimit të metalit në kova;
6. Fonditor;
7. Punëtor i formave që merr pjesë në fonderi;
8. Mjeshtër ose ndihmës i tij;
9. Punonjësit e pasurimit të kuarcit.

III. A. PUNËT NË FONDERI

1. Shkrirës në furrat kubilot, me hark, me induksion dhe me lëndë djegëse;
2. Derdhës dhe transportues i metalit të lëngët me kova;
3. Punëtor i derdhjes në konkilje të metalit të shkrirë;
4. Punëtor i derdhjes në centrifugë;
5. Punëtor i përgatitjes së ngarkesave e të ferrolidhjeve dhe punëtor i thyerjes së depozitave;
6. Punëtor i muratimit të furrave e të kovave;
7. Vinçier në sektorin e shkrirjes e të derdhjes;
8. Punëtor përgatitës i formave;
9. Punëtor i përgatitjes së përzierjeve formuese në agregatin e dherave;
10. Punëtor shkatërrues i formave;
11. Punëtor i përgatitjes së zemrave;
12. Punëtor i pastrimit të detaleve të derdhura dhe i pastrimit kimik në fonderi;
13. Saldator i gizës në të nxehtë (700° C).

III. B. PUNËT NË FARKËTARI

Punët që punojnë me çekiç me peshën rënëse 100 kg e lart dhe në presat me friksion me fuqi goditëse 100 ton e lart.

IV. PUNA NË SEKTORË TË TJERË

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Polombar;
2. Saldator dhe elektrosaldator në rezervuar, kulla dhe cisterna;
3. Punëtor i pastrimit të brendshëm të rezervuarëve, depove dhe cisternave të naftës;
4. Punonjësit që punojnë me solucione dhe aerosole radioaktive;
5. Çekanist, karbonist, montator- ribatinist, që merren me riparimin e anijeve dhe të nëndetëseve.

V. PUNA NË ARSIM - KULTURË

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Artistë të baletit;
2. Akrobatë dhe gjimnastë të cirkut;
3. Solistë të operas, teatrove muzikale dhe të ansambleve shtetërore;
4. Muzikantë të veglave të frymës të orkestrave dhe të bandave shtetërore;
5. Artistët e valleve të asambleve shtetërore dhe koristët e operas, të teatrove muzikore dhe të ansambleve shtetërore.

VI. PUNA NË USHTRI

Punë e tillë quhet puna e kryer si:

1. Ushtarak që bën fluturime ajrore;
2. Ushtarak i reparteve të nëndetëseve.

VII. PUNËT NË INDUSTRINË USHTARAKE

Punë e kategorisë së parë:

1. Në prodhimin e lëndëve eksplozive: punëtor i përzierjes, i peshimit dhe i sitjes së trolitit, të nitrat amonit dhe të nitratit kaliumit:
   - punëtor i bluarjes dhe i thërrmimit të trolitit;
   - punëtor i shkrirjes dhe i derdhjes së tritolit në forma;
   - punëtor i presimit dhe i shpimit të birave të kallëpëve të trolitit;
   - brigadier që punon direkt në prodhim në proceset e mësipërme.
2. Në prodhimin e lëndëve plasëse iniciale:
   - punëtor i përzierjes, i peshimit, i mbushjes dhe i presimit të lëndës plasëse iniciale,
   - brigadier që punon direkt në proceset e mësipërme.
3. Në përdorimin e lëndëve helmuese luftarake:
   - kimist, mjek dhe laborant toksikolog në sintetizimin dhe eksperimentimin e

lëndëve helmuese luftarake në laboratorët qendrorë (kimike dhe toksikologjike;
- magazinier dhe ndihmësmagazinier i lëndëve helmuese luftarake në repartin ushtarak 8770.

4. Në kombinatin e Poliçanit:
   - punëtorët e montimit të kapsollave ndezëse, detonatore, ndezësve, fishekëve bazë e mbushjeve plotësuese, ngarkesave akumulative, gotave dotanatore, kallëpëve me lëndë brizante e piroteknike, diafragmave, ngadalësuesve, fishekëve shenjëdhënës e ndriçues, fishekzjarre, prodhimi i djegoreve e artikuj plasës;
   - punëtorët e prodhimit e të rigjenerimit të minave, granatave, predhave dhe artikujve të tjerë me lëndë plasëse;
   - punëtorët që punojnë në përpunimin e lëndëve oksiduese dhe djegëse, të lëndëve goditëse dhe shpuese;
   - punëtorët e provave të artikujve luftarakë me lëndë plasëse, kapsolla, fishekë, mina, granata, predha, djegore e ndezëse;
   - punëtorë që punojnë në përgatitjen dhe përdorimin e kazeinës e të amoniakut;
   - punëtorët që punojnë në proceset e larjes kimike dhe galvanizimit për veshje kimike të ndryshme, si mina, granata, predha, ndezës, fishekë e djegore;
   - punëtorët që punojnë në llakimin, sprucimin me pistoletë, veshje me shtytje dhe lyerje me bojë smalti e nitro dhe tretësira organike, bashkimin dhe saldimin e minave, predhave e granatave, si dhe të artikujve të tjerë luftarakë;
   - punëtorët që punojnë në proceset e prodhimit të therjes së sitjes së lëndës plasëse, iniciale, fulminant zhive, Pb (N3)2;
   - punëtorët e peshimit, përzierjes, mbushjes e presimit të lëndëve shpuese e goditëse, transportit të lëndëve iniciale, goditëse dhe shpuese;
   - punëtorët që punojnë në shkrirjen dhe kristalizimin, derdhjen e TNT në formë, në bluarje, thërrmimin, përzierjen, sitjen dhe peshimin e TNT;
   - punëtorët që punojnë në përgatitjen dhe presimin e kallëpeve të TNT;
   - punëtorët e pastrimit të filetave të granatave, të predhave nga pluhurat e TNT-së, pastrimi me furçë teli të brezave të predhave e granatave;
   - punëtorët e mbushjes, presimit të TNT, bashkimin e montimin e pjesëve të granatave dhe formimin e llakërimin e birave të mbushjeve;
   - punëtorët e ngrohjes, mbushjes, peshimit, presimit të TNT-së prerjes së mbushjeve me TNT, pastrimi i kallëpëve, montimi i tyre në predha, mina e granata në forma;
   - përgatitësit e tretësirave gërryese, smifke të shtresave të bojës që përmbajnë fenol, eter amoniak, etilacetat;
   - punëtorët që punojnë në futjen dhe nxjerrjen e trupave në tretësirë të lartë, pastrimin e trupave, filetave, njomjen e trupave, si dhe proceset e tjera që kryhen në mjedise me avuj fenoli;
   - punëtorët që punojnë në pastrimin dhe bombardimin me rërë të puluarizuar, përzierja e ajrit me kokrriza të imta kuarcore me përmbajtje të lartë silici të minave, predhave, granatave e stabilizatorëve;
   - punëtorët që punojnë në përzierjen e lëndëve plasëse shenjëdhënëse e ngadalësuese;
   - punëtorët që punojnë në çarmatosjen e artikujve luftarakë;
   - punëtorët që punojnë në injektimin e lidhjeve të aluminit;
   - laborantët e lëndëve plasëse iniciale;
   - punëtorët që punojnë.në pastrimin me ajër të formave me kapsolla, detonatorë, kapsolla ndezëse, nxjerrjen e kapsollave detonatore dhe ndezëse nga format, shkundja e formave me kapsolla detonatore;
   - punonjësit që punojnë në tunele;

- punëtorët në bunkerin e dheut të repartit të fonderisë, shkrirja e plumbit dhe përpunimi i tij në atë sektor;
- punëtorët që punojnë në prodhimin e detaleve prej bakeliti;
- mirëmbajtësit dhe laborantet e fonderisë, punëtoret e fonderisë.

VIII. PUNËT NË INDUSTRINË E BAKRIT

a) Në metalurgji:

1. Punëtor i ngarkesës së furrës;
2. Punëtor në kroxholin e furrës;
3. Konuertorist biraç dhe punëtor konvertori;
4. Pjekës dhe kryepjekës aglomerati;
5. Punëtor i thyerjes dhe transportit të aglomeratit;
6. Punëtor i thyerjes së skorjeve dhe metalinës;
7. Vagonist që furnizon furrën me materiale të nxehta;
8. Punëtor dhe murator i prishjes dhe veshjes së konvertorëve dhe furrave;
9. Punëtor i pastrimit të pluhurave të furrës, kanaleve të skorjes, kallëpëve të bakrit dhe përgatitjes së kovave;
10. Punëtor i shqepjes së kapave të furrës;
11. Manovrues i vinçave në metalurgji;
12. Fonditor;
13. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në proceset e sipërme.

b) Në rafinimin e bakrit:

1. Punëtor që merr pjesë në proceset e furrës anodike dhe katodike;
2. Punëtor i elektrolizës në kontrollin e operacionit për përgatitjen e fletëve bazë (procesi i parafinës) në ngarkim-shkarkim dhe në filtrim të llampave;
3. Punëtor që punon në procesin e shllameve dhe sulfatit të bakrit e nikelit;
4. Punëtor i shkrirjes dhe larjes së tunxhit e të bronxit;
5. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në proceset e mësipërme.

c) Në uzinën e telave:

1. Petëzues dhe regjistrues (kolaudues) i linjës së ashpër e të pastër të bakrit.

IX. PUNËT NË INDUSTRINË KIMIKE

a) Në uzinën e nitrat amonit:

1. Punëtor i përgatitjes së solucioneve arsenike;
2. Punëtor i pastrimit të squfurit nga arseniku;
3. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në proceset e sipërme;
4. Punëtor i komprimimit të gazit metan, azot, ajër + oksigjen + amoniak, gaz karbonik, metan + ajër;
5. Punëtori i mirëmbajtjes dhe i remontit në repartin e kompresorëve;
6. Punëtori i turbinës në repartin e prodhimit të acidit nitrik /turbinist);
7. Punëtori në pompat e presionit të lartë dhe në postin e sintezës së uresë, punëtori i remontit dhe i mirëmbajtjes të pajisjeve në repartin e uresë.

b) Në uzinën e superfosfatit:

1. Punëtor i fluorosilikat natriumit;
2. Punëtor në absorbimin e gazrave të fluorit;
3. Punëtor që punon me llak në repartin e antikorozionit,
4. Punëtor i përzierjes dhe pjekjes së superfosfatit;
5. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në proceset e mësipërme.

c) Në uzinën e PVC:

1. Në repartin e elektrolizës:

- Teknolog vaske, punëtor i mirëmbajtjes dhe remontit të makinerive e pajisjeve me zhivë, rregullimit të tensioneve të vaskave të elektrolizës, mirëmbajtjes së çelësave, punimeve të destilimit të zhivës dhe të demerkurizimit të ujërave.

2. Në repartin e klorit dhe polimer- klorivinilit:

- Punëtor ambalazhues të hipokloritit;
- Punëtor i kompresorëve në klorivinil, punime kryesore e ndihmëse në katalizator, i drejtimit të pultit të komandimit në polimer, i punimeve kryesore e ndihmëse në polimerizim të aparatit të centrifugës.

ç) Ndërmarrja e prodhimit të kripës së detit:

1. Punëtor i prodhimit të kripës së detit, fugist, punëtor bartës.

X. PUNËT NË PRODHIMIN E BATERIVE

1. Punëtor i shkrirjes dhe derdhjes së rrjetave;
2. Punëtor i ngjitjes së rrjetave;
3. Punëtor i bluarjes dhe përgatitjes së pastër të oksidit.

XI. PUNËT NË INDUSTRINË E NAFTËS

a) Brigadat e remontit nëntokësor të puseve të naftës dhe gazit:

1. Operator (përgjegjës kyçi);
2. Ndihmësoperator (punëtor pastrimi).

XII. PUNËT NË METALURGJINË E ZEZË E FERROKROM:

1. Në uzinën e petëzimit:

a. Petëzues;

2. Regjistrues;
3. Nxjerrës metali në petëzimin e imët.

b. Në uzinën e gizës

Në repartin e furrnaltës:

- punëtorë dhe ndihmës të topit elektrik;
- punëtorë të shërbimit të kanalit të derdhjes së gizës dhe skorjes.

Në fabrikën e aglomerimit:

Në repartin e pjekjes:

- punëtor në sitën e nxehtë të aglomerimit;
- punëtor në transportierin 19 (nëntokësor);
- punëtor i copëtimit të aglomerimit.

Në repartin e lëndës së parë në fabrikën e aglomerimit:

-në depon e koncentratit (26-PJ-1) vinçier të vinçit "grefer" punëtor i gazrave.

Në repartin e lëndës së parë në furrnaltë:

-punëtor i transportierit BA·88·9 (nëntokësor).

Në repartin e makinës së derdhjes (obj.45):

-punëtor i shërbimit të ullukut.

c. Në uzinën e çelikut:

Në repartet e shkrirjes (konverta e furrat elektrike me hark):

- shkrirës të reparteve furra elektrike me hark, konverta e kova lëkundëse;
- punëtor derdhës i çelikut në konkie;
- punëtor derdhës i çelikut në makinat e derdhjes së pandërprerë të kovës 25 tonëshe, të kovës;
- ndërmjetëse, drejtues i derdhjes;
- punëtor i platformave, punëtor i montim - çmontimit të konkileve.

ç) Në uzinën nr.12:

Në repartin e finjëzimit:

- Punëtor i pastrimit të kolonave dhe dekantuesve.

d) Në uzinën kokso- kimike:

- Në repartin e koksifikimit;
- Punëtor i kapakëve të ngarkimit;
- Makinist e ndihmësmakinist i ngarkimit;
- Teknolog i tubave vertikale;
- Punëtor i pastrimit të dritave;
- Makinist i vagonit të shuarjes së koksit;

- Teknolog i rregullimit të temperaturave;
- Punëtor remontier dritaresh;
- Mekanik i detaleve të nxehta.

dh) Në ndërmarrjen karbonike:

1. Punëtor i reparteve kryesore teknologjike (makinistë e teknologë).

e) Në uzinën e nikel – kobaltit:

- Punëtor i teknologjisë së shkrirjes, derdhjes dhe elektrolizës.

f) Punët në uzinat e ferrokromit:

- Punëtor i ngarkesës së furrës me lëndë të para e masë elektrode, të drejtimit të procesit teknologjik (kuota 5 ml e furrës) të derdhjes së metalit të shkrirë, vinçier i derdhjes së masës së shkrirë, derdhjes së metalit të shkrirë, vinçier i derdhjes së masës së shkrirë, derdhjes e shkrirjes së bronzit, zhbllokimit të kovave, linjës së granulimit të skorjes, saldator i procesit teknologjik të furrave.

XIII. Punët në miniera e gjeologji:

-mekanik, elektricist dhe punonjës të tjerë në nëntokë.

XIV. Punët e avaro-shpëtimit në miniera:

- Punëtorë avaro-shpëtues në miniera.

PASQYRA NR.2 E PUNËVE QË HYJNË NË KATEGORINË II

Punë që hyjnë në kategorinë II quhen:

I. PUNËT NË MINIERA NËNTOKË:

Punë e kryer në miniera nëntokë quhet puna e kryer nga drejtuesit dhe inxhiniero-teknikët që ka lidhje direkte me drejtimin dhe kontrollin e punimeve në miniera nëntokë, si:

1. Drejtor ose përgjegjës për shfrytëzimin e minierave ose si zëvendës i tyre në prodhim;
2. Drejtor ose përgjegjës i ndërmarrjes së ndërtimit të minierave dhe kërkimeve të mineraleve nëntokë ose si zëvendës i tyre;
3. Kryeinxhinier, inxhinier, kryegjeolog, gjeolog, mekanik elektricist dhe marsheder në miniera nëntokë ose si zëvendës i tyre.

I. a. Puna në punimet e tjera në nëntokë:

1. Mekanik në nëntokë, elektricist në nëntokë.

II. PUNËT NË MINIERA NË SIPËRFAQE:

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Minator, ndihmësminator, vagonist, punëtor i ngarkimit të mineralit, eskavatorist, buldozerist, makinist i lokomotivave;
2. Drejtor ose përgjegjës i shfrytëzimit të minierave ose si zëvendës i tyre në prodhim;
3. Drejtor ose përgjegjës i ndërmarrjes së ndërtimit të minierave dhe kërkimeve të mineraleve ose si zëvendës i tyre;
4. Kryeinxhinier, inxhinier, kryegjeolog, gjeolog, mekanik, elektriçist dhe marsheder, ose si zëvendës i tyre;
5. Brigadier, përgjegjës reparti ose turni;
6. Shpëtuesit dhe inspektorët e repartit të inspektim-shpëtimit të minierave, komandanti i repartit.

III. PUNËT NË GJEOLOGJI

Punë e tillë quhet puna e kryer si:

1. Motorist i stacioneve të pompimit të ujit, motokompresorëve dhe grupeve elektrike;
2. Punëtor i montimit çmontimit dhe transportimit të sondave;
3. Punëtorë të hapjes së kanaleve për kërkime gjeologjike;
4. Punonjës i rivelimeve gjeologjike, i punimeve topografike dhe marshenderike;
5. Inxhiniero-teknik i ekspeditave, grupeve dhe reparteve që merren me punime dhe kërkime gjeologjike, hidrogjeologjike dhe hidrogjeofizike;
6. Kryesondist, sondist dhe ndihmëssondist, sondist- shofer.

IV. PUNËT NË INDUSTRINË E GOMËS

Punë e tillë quhet puna e kryer si:

1. Punëtor në repartin e kalandrave;
2. Punëtor për përgatitjen e lëndëve kimike dhe të mastiçes;
3. Punëtor në repartin e gomave dhe kamerdareve, punëtor në repartin e përgatitjes të gjysëm prodhimeve dhe artikujve teknikë për gomat dhe kamerdaret, punëtor në repartin e prodhimeve teknike, në repartin gomë-metalit, në repartin e punimeve me dorë dhe në repartin special;
4. Punëtor në repartin e këpucëve dhe çizmeve prej gome, punëtor në repartin e përgatitjes së gjysmë prodhimeve të këpucëve dhe çizmeve prej gome, me përjashtim të punës që bën punëtori i klasifikimit dhe ambalazhimit të tyre;
5. Punëtor i gomimit të tekstileve.

V. PUNËT NË INDUSTRINË E NAFTËS

Sektori i shpim kërkimit dhe shpim shfrytëzimit:

a) Brigadat e shpimit të puseve;

1. Sondator (K / sondator);
2. Pompist;
3. Motorist;
4. Pompist i pusit;
5. Punëtor i shpimit;
6. Axhustator;
7. Elektricist.

b) Brigadat e montimit dhe çmontimit të sondave:

1. Montator sondash;
2. Karpentier;
3. Punëtor montimi dhe çmontimi;
4. Motorist i saldatriçes.

c) Brigadat e traktorëve të transport- furnizimit të puseve:

1. Traktorist;
2. Punëtor i transportit.

e) Brigadat e impiantit të argjilës:

1. Punëtor i bluarjes së argjilës;

Sektori i nxjerrjes së naftës dhe të gazit:

a) Grupet e nxjerrjes dhe të grumbullimit të naftës dhe të gazit:

1. Operator i shfrytëzimit të puseve (pompist);
2. Axhustator;
3. Përgjegjës turni;
4. Fugist;
5. Operator i studimit të puseve;
6. Kompresorist i gazit.

b) Brigadat e remontit nëntokësor të puseve të naftës dhe të gazit:

1. Traktorist, organist i arganellove;
2. Operator i përgatitjes së vendit të punës.

c) Brigadat e remontit të pompave të thellësisë:

1. Axhustator

e) Brigadat e montimit të kullave:

1. Montator;
2. Punëtor i montimit

Sektori i punimeve gjeologo- gjeofizike në naftë edhe gaz:

a) Grupet e çimentimit të puseve:

1. Punëtor i çimentimit të puseve, pompist, pompist agregati dhe punëtor agregati;
2. Makinist i grupit të çimentimit, shofer agregati, shofer motorist-agregati.

b) Grupet e karrotazh-perforimit të puseve:

1. Operator;
2. Makinist i uljes dhe ngritjes së stacionit të karrotazhit dhe të perforimit, shofer organist dhe organist;
3. Punëtor i mbushjes së aparateve të qëllimit;
4. Punëtor i karrotazh - perforimit, motogjeneratorist në gazokarrotogen;
5. Makinist laboratori.
Sektori i transportit të naftës së gazit:
a) Stacioni i grumbullimit dhe shpërndarjes së naftës dhe gazit:
1. Operator i stacionit të pompimit (pompimit);
2. Fugist;
3. Punëtor i ngarkimit të autoboteve dhe cisternave;
4. Punëtorët e ndërmarrjes së karburanteve, si: pompistët, mirëmbajtësit e linjave teknologjike, mbushësat, punëtorët e ngarkim-shkarkimit dhe shitësit në vendet e shpërndarjes së karburantit.
b) Stacioni i bitumit të lëngshëm:
1. Operator i stacionit të pompimit;
2. Axhustator;
3. Shkarkues i bitumit.
Sektori i përpunimit të naftës:
a) Reparti i distilimit atmosferiko-vakum, i pastrimit të produkteve dhe parku i karburanteve:
1. Përgjegjës turni;
2. Operator;
3. Fugist;
4. Pompist;
5. Kompresorist i vakumit;
6. Punëtor i përgatitjes së reagentëve kimikë;
7. Punëtor i parkut të karburanteve.
b) Reparti i bitumit:
1. Operator dhe ndihmësoperator;
2. Punëtor bitumist;
3. Punëtor i ngjyrosjes së fuçive me bojë bituminoze.
c) Impianti i prodhimit të grasos:
1. Operator i prodhimit të grasos.
e) Reparti i koksit:
1. Kryeoperatori e operatori i impiantit të koksit;
2. Fugist dhe ndihmësfugist;
3. Punëtor i pastrimit të kazanëve të koksit;
4. Punëtori i rimontit të impiantit të koksit;
5. Pompisti;
6. Ndihmëspompisti;
7. Arganisti;
8. Kompresoristi;
9. Punëtor i seleksionimit të koksit;
10. Muratori;
11. Saldatori që ka punuar në repartin e koksit për koksifikimin e bitumit të naftës në vitet 1965-1971.
d) Punët në kombinatin e PTHN:
1. Impianti i distilimit atmosferik:
Teknolog, fugist, pompist, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.
2. Impianti i koksifikimit:
Teknolog, fugist, kompresorist, pompist, sondist, punëtor bankoporte, vinçier, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.

3. Impianti i hidropastrimit të karburanteve:

Teknolog, pompist, kompresorist, fugist, përgjegjës ndërrese, mirëmbajtës.

4. Impianti i hidrogjenit dhe i platformingut:

Teknolog, fugist, kompresorist, pompist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.

5. Impianti i pastrimit të gazit dhe i prodhimit të squfurit e solvenit:

Teknolog, pompist, punëtor i formimit të squfurit, mirëmbajtjes, përgjegjës ndërrese.

6. Reparti i transportit të naftës e gazit:

Teknolog, pompist, punëtor i përgatitjes së sodës, dispeçer, manovrues, kryemanovrues, punëtor kalese, punëtor i mbushjes së bombolave të gazit dhe i kolaudimit të tyre, punëtor i mbushjes së cisternave e autoboteve, mirëmbajtjes, përgjegjës ndërrese.

7. Reparti i ujëngrohjes dhe laboratori kimik i karburantëve e vajrave:

Teknolog, pompist, kompresorist, mirëmbajtjes, punëtor i marrjes së kampioneve dhe i përpunimit kimik, përpunues qelqi, përgjegjës ndërrese.

8. Repartet e ruajtjes, transportit të vajrave reagentëve kimikë e lëndëve djegëse, larjes, mbushjes e manipulimit të fuçive elektrik, remontit të rezervuarëve.

Teknolog, pompist, motorist, mbushës i fuçive dhe autobotëve, mirëmbajtjes, përgjegjës ndërrese, elektrovinçier, marketues i fuçive, bojaxhi i lyerjes së rezervuarëve, mekanik, montator, saldator, kipist në ndërresë, mirëmbajtës elektrik e telefonik, mbajtës i nënstacioneve në repart që punojnë me ndërresa.

9. Impiant i distilimit në vakum të vajrave lubrifikante, desfotizimit me propan i vajrave lubrifikante ekstraktimit me furfurol të vajrave lubrifikante.

Teknolog, fugist, pompist, kompresorist, turbopompist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.

10. Impiantet e deparafinimit, hidropastrimit të vajrave lubrifikante.

Teknolog, pompist, kompresorist, fugist, mirëmbajtës, përgjegjës ndërrese.

11. Impianti i prodhimit të propanit e parafinës dhe përzierjes së vajrave lubrifikante.

-Teknolog, pompist, punëtor i ambalazhimit të parafinës, mirëmbajtjes, përgjegjës ndërrese, elektrovinçier.

12. Repartet e remontit mekanik, mirëmbajtjes, të inspektimit, shpëtimit e kontrollit teknik.

-Punëtor të riparimit të pompave, kompresorëve e pajisjeve statike që punojnë me ndërresa, shpëtues, laborantë të analizave, bojaxhinj, përgjegjës reparti, inxhinierë në impiantet dhe repartet teknologjike.

VI. PUNËT NË CENTRALET ELEKTRIKE, HEKURUDHAT DHE NË PRODHIMIN E AVULLIT PËR NEVOJAT E PRODHIMIT

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Kaldajist ose punëtor i pastrimit të kaldajave;
2. Transportues i hirit të qymyrit të djegur nga furrat;
3. Punëtor i kontrollit të ujit;
4. Furnizues i furrës me lëndë djegëse.

VII. PUNËT NË MINIERËN E SERËS

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i shkrirjes së serës dhe derdhës së saj të shkrirë në forma;
2. Brigadier dhe inxhiniero - teknik i turnit.

VIII. PUNËT NË PRODHIMIN E TULLAVE, TJEGULLAVE DHE ARTIKUJVE PREJ QERAMIKE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i vendosjes dhe nxjerrjes së tullave, tjegullave dhe artikujve të tjerë nga furrat e pjekjes;
2. Punëtor i shkrirjes së plumbit për zmalto për poçeri.

IX. PUNËT NË PRODHIMIN E ÇIMENTOS

- Në pikën 1, emërtimet "gudist i pjekjes së klingerit, punëtorët" saktësohen me emërtimet: "Fugist e ndihmësfugist i pjekjes së klingerit, makinist dhe ndihmës i ftohësit, punëtor i transportierit të klingerit, i fundit të nxehtë të furrës, i lagies së materialeve dhe makinist i shkarkimit të furrës".

- Në pikën 2, emërtimet: "Punëtor i sillosit, i makinave të bluarjes së çimentos, të qymyrgurit dhe të bluarjes së lëndës së parë", saktësohen me emërtimet:

a) Bluarja e çimentos:

"Makinist e ndihmësmakinist i mullirit, ushqyes dhe pompist i mullirit, punëtor i transportit me transportier dhe vagon i elektrofiltruesit dhe filtrave me mëngë, i seperatorit, ekektrovinçier e depos së përbashkët".

b) Punëtorët e qymyrgurit:

"Makinist e ndihmës i copëtimit dhe i bluarjes së qymyrgurit, punëtor i ushqyesit të qymyrgurit, i separatorit të qymyrgurit, i transportierit të qymyrgurit, punëtor dhe ndihmës i furrës së gazrave".

c) Bluarja e lëndës së parë:

"Makinist e ndihmës i gurëthyeses, punëtor i transportit me transportier dhe vagon, makinist e ndihmës i mullirit, punëtor i ushqimit të mullirit, i pompave të shllamit, makinist i tretësit të argjilës, makinist e ndihmës i tharjes së shtresave të lëndës së parë.

e) Punëtorët e sillosit:

"Punëtor i mbushjes dhe paketimit, motorist i valvulës dhe i ushqimit, punëtor i ngarkimit, i filtrit me mëngë dhe i stampimit.

Në pikën 3, emërtimet "*Punëtorët e ambalazhimit të çimentos dhe i pastrimit të dhomave nga pluhuri i çimentos*", saktësohet: "punëtor i pastrimit të silloseve të çimentos".

X. PUNË NË PRODHIMIN E XHAMIT, QELQIT DHE TË LLAMPAVE ELEKTRIKE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i ngarkimit të furrës;
2. Punëtor i shkrirjes;
3. Fryrës i qelqit;
4. Fonditor;
5. Punëtor i tërheqjes së tubave të llampave luminishente dhe të tubave të qelqit;
6. Punëtor i pastrimit të zhivës.

XI. PUNËT NË INDUSTRINË E TEKSTILEVE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

a. Punëtor ose inxhiniero-teknik që punon direkt në përgatitjen e bojërave, të solucioneve dhe në repartin e zbardhjes dhe të ngjyrosjes;

b. Tezgjahist, filaturist dhe teknik i shfrytëzimit të makinave të tezgjahut e të filaturës, si:

1. Vendosës dengjesh e shtrues stafke;
2. Punëtor shkrifës pambuku dhe leshi;
3. Punëtor shtëllunge;
4. Punëtor krehës (pambuku e leshi krehje e zakonshme dhe e lartë);
5. Punëtor pastrues të tambureve, të barabartë të makinës së krehjes, të mprehjes së tambureve të krehjes dhe brigadat e pastrimit në filaturë e në tezgjah;
6. Punëtor fjongo bashkuese;
7. Punëtor tërheqje;
8. Punëtor tërheqje shtëllunge;
9. Punëtor fitiliste;
10. Punëtor tjerrëse;
11. Punëtor dredhëse;
12. Punëtor ulje ngritje pllanke;
13. Punëtor heqje sjomi;

14. Punëtor shkrifës shtëllunge, vate farërash fitili, unazash;
15. Punëtore makiniste e ndihmësmakiniste në makinat e karnonizimit;
16. Vlerësuese të fillit;
17. Punëtor mbledhës;
18. Punëtor shumëfishimi;
19. Punëtor motoville;
20. Punëtor rimbledhje;
21. Punëtor endës;
22. Punëtor vënës bobinash;
23. Punëtor kollaritës;
24. Punëtor përshkues (marrës dhënës);
25. Punëtore të makinave nyjelidhëse;
26. Punëtor lidhës bazash;
27. Punëtor tezgjahu;
28. Teknike të shfrytëzimit të makinave në fabrikat e filaturës dhe tezgjahëve (ndihmës teknik);
29. Vënës masuri e meçiku;
30. Punëtor vënës beze;
31. Punëtor likuidues;
32. Punëtor të prerjes së kadifes me disqe, thika brisqe;
33. Punëtor pastrues sheshesh, bodrumesh, filtrash e kollonash;
34. Transportuesit e prodhimit dhe gjysmë fabrikateve;
35. Punëtorët e heqjes së firove në filaturë;
36. Punëtorët e përcëllimit të kadifes dhe penjët e qepjes;
37. Punëtor pastrues, prerës mëshikëze e shtëllunge;
38. Punëtore zjerës e zbutës mëshikëze;
39. Punëtore të gjetjes së fillit fillestar të çmbështjelljes së fillit të mëndafshit;
40. Punëtoret përpunues të nënprodukteve të mëndafshit dhe shkulave;
41. Instruktoret e prodhimit dhe përgjegjësit e turneve të fabrikave të filaturës dhe tezgjahut;
42. Klasifikues i leshit të palarë;
43. Vlerësues i ndarjes së leshit në cilësi;
44. Makinist në agregatin e larjes, tharjes së leshit, në sektorin e përzierjes e pushëzim leckash, shkundjes së pluhurit, përgatitjes së kokrrizave, krehje mbeturinash, hapje radhësh me makinë dhe punëtore për punim fijesh të dredhura në makinat e krehjes në përpunim fijesh të mbledhura në makinat e krehjes;
45. Punëtorë të mirëmbajtjes dhe likuidimit të difekteve të rënda.

XII. PUNËT NË INDUSTRINË E LËKURAVE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i skarnimit të lëkurëve, regjjes, vaskave të regjjes dhe ngjyrosjes së lëkurëve me ngjyrë aniline.

XIII. PUNËT NË INDUSTRINË E DRURIT, NË INDUSTRINË E LETRËS DHE PLLAKEVE TË ZDRUKTHIT

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i sharrave që pret dhe transporton lëndën e drurit nga pyjet;
2. Punëtor i imprenjimit të drurit që i ekspozohet avujve të kreozotit dhe klorit të zinkut; dhe si punëtor që merret me përgatitjen e këtyre lëndëve kimike;
3. Punëtor i prodhimit të lëndëve ngjitëse sintetike dhe të tekstolitit;
4. Punëtor i përzierjes së lëndëve ngjitëse me zdrukthin, formist i pllakave të zdrukthit i parapresimit, i presimit të skuadrimit dhe i pastrimit të llamarinave në fabrikën e pllakave të zdrukthit;
5. Punëtor i repartit të hipokloritit të kalciumit dhe përgatitjes së solucionit kimik të zierjes në fabrikat e letrës;

6. Punëtor i ngarkim - shkarkimit, stivimit dhe i transportimit të lëndës drusore.

XIV. PUNËT NË INDUSTRINË E FERMENTIMIT TË DUHANIT

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i mbushjes dhe zbrazjes së dhomave të fermentimit;
2. Punëtor i mbajtjes së regjimit në dhomat e fermentimit.

XV. PUNËT NË INDUSTRINË E CIGAREVE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor në repartin e harmanit, të makinave të prodhimit të cigareve dhe të mbushjes së paketave me cigare, dhe si punëtor i pastrimit të këtyre reparteve;
2. Mjeshtër i repartit të harmanit, të prodhimit të cigareve dhe të mbushjes së paketave me cigare.

XVI. PUNËT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Infermier në klinikat e lebrozëve;
2. Infermiere, kujdestare e sanitare në repartet psikiatrike, në shtëpitë e fëmijës e të pleqve me të meta mendore, prosektore dhe inferniere në sallat e autopsisë të anatomisë patologjike e të mjekësisë ligjore, anestezisë, të anatomisë patologjike e të mjekësisë ligjore, anestezisë dhe reanimatorë të sallave të operacionit, infermier në repartet infektive;
3. Bojaxhinjtë e ujërave sulfurore të llixhave.

XVII. PUNËT NË NDËRTIM

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Punëtor i asfaltimit (zierës i serës dhe asfaltues), si dhe i hidroizolimit me serë;
2. Punëtor që përgatit betonin;
3. Punëtor që ngre oxhaqe industriale ose si ndihmës i tij;
4. Sondist (punëtor i shpimit) montator dhe elektromontator i linjave të tensionit të lartë;
5. Eskavatorist, buldozerist dhe skreperist;
6. Minator në gurore, si dhe punëtorët që punojnë në pus-tunel në nëntokë (makinist dhe ndihmësmakinist, elektrovozist, mekanik dhe elektricist), në fabrikën e çimentos në Fushë – Krujë;
7. Rulist (që punon në cilindra për sheshimin e rrugëve);
8. Minator në karierat e argjilave.

XVIII. PUNËT NË POLIGRAFI

Punë e tillë quhet puna e kryer si:

1. Punëtor i radhitjes dhe çradhitjes me dorë dhe i faqosjes në shtypshkronjë;
2. Punëtor i radhitjes në linotip;
3. Punëtor i centrografisë dhe fotografisë me ofsejt;
4. Punëtor i steriotipisë;
5. Shkrirës i plumbit;
6. Punëtor i monotipeve
7. Punëtor i derdhjes së shkronjave;
8. Punëtorë që punojnë në sektorët e shtypit të lartë, ofsejt dhe të thellë të cilët janë:

8/1. Punëtor makinist dhe ndihmës të shtypit të lartë, rrotative, ofsejt dhe të thellë, multilidh e rrotaprint dhe të celefonimit në të ftohtë;

8/2. Punëtorë makinist dhe ndihmëse në pedalinë të shtypit të lartë;

8/3. Punëtorë përpunues, kombinues bojrash të shtypit të lartë, rrotativ,ofsejt dhe të thellë;

8/4. Punëtorët kolaudues fashikujsh të shtypit të lartë, rrotativ, ofsejt të thellë, rotaprint e multilidh dhe të celefonimit në të ftohtë;

8/5. Punëtorët numërues të fashikujve në repartin e shtypit të lartë, rrotativ, ofsejt, multilidh e rrotaprint dhe celefonimit në të ftohtë;

8/6. Punëtorët transportues të brendshëm në repartet e shtypit të lartë rrotativ, ofset, multilidh e rrotaprint dhe celefonimit në të ftohtë;

8/7. Punëtorët makinistë e ndihmëse në thika që punojnë në mjediset e repartit të shtypit të lartë, ofsejt, të thellë dhe celefonimit në të ftohtë;
8/8. Punëtorët makinistë dhe makinistë të provakopjes, të shtypit të thellë dhe ofsejt;
8/9. Kontrolloret e cilësisë së repartit të lartë, rrotativ, ofsejt, të thellë dhe cinkografisë;
8/10. Punëtorët galvanizues, bakërzues, kromues, luçidues të formave të shtypit të thellë;
8/11. Punëtorët e kontaktit të shtypit të thellë dhe ofsejt;
8/12. Punëtorë kopistë të formave të shtypit të ofsejt të thellë multilidh e rrotaprint.

XIX. PUNËT NË ANIJET E TRANSPORTIT DETAR UJOR NË ANIJET E PESHKIMIT DHE NË MJETE PORTUALE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:
1. Kapiten, oficer, kujdestar (nostrom) në anijet e transportit detar të brendshëm e të jashtëm;
2. Marinar, mekanik, motorist, fugiste grasatorist ose si ndihmës i tyre;
3. Punëtor i peshkimit, që peshkon në det;
4. Kallafator (gërryes i ndryshkut dhe bojatisjes i dopiofundeve dhe mjediseve të tjera të brendshme e të jashtme të anijeve metalike) në kantieret dhe repartet e riparimit të mjeteve detare;
5. Pastrues të kaldajave të anijeve avullore.

XX. PUNËT NË NDËRLIDHJE

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:
1. Telefonist i centraleve të lidhjes midis qyteteve, i kabinave telefonike që punon gjithë ditën e punës dhe i centraleve telefonike të qyteteve me kapacitet prej 200 e më shumë numra;
2. Telegrafist që punon me aparate mors.

XXI. PUNËT NË FARKËTARI ME KRAH E ME ÇEKIÇ DERI NË 99 KG DHE NË PRESAT DERI NË 99 TON.

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:
1. Punëtor i nxehjes së metalit, i thyerjes dhe kthimit të metalit;
2. Farkëtar dhe rrahës i metalit me dorë dhe me çekiç ose si ndihmës i tyre;
3. Punëtor i presimit dhe stampimit të metalit të nxehtë;
4. Mjeshtër dhe ndihmësmjeshtër në repartin e farkëtimit;
5. Punëtorët e mirëmbajtjes, mekanik, elektrik, hidraulik, muratorë, si dhe vinçierët, atrecuesit dhe përzgjedhësit;
6. Përgjegjësit e ndresës, teknologët, përgjegjësi i repartit dhe kontrollorët e cilësisë.

XXII. PUNËT NË SEKTORË TË TJERË

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:
1. Baterist i mbushjes së akumulatorëve prej plumbi dhe baterive;
2. Elektrovinçier, fokist, i kaldajave, makinist ose si ndihmës të tyre në lokomotivat e trenave që punojnë me avull;
3. Makinist dhe ndihmësmakinist i turbinave me avull dhe i motorëve me djegie të brendshme të centraleve elektrike me kapacitet mbi 500 kilovat, mashinist dhe ndihmësit e tyre në lokomotiva mbi 500 kilovat;
4. Saldator dhe elektrosaldator ose si ndihmës i tyre;
5. Punëtor i pastrimit të gropave të zeza dhe i nevojave publike;
6. Punëtor i ngarkim-shkarkimit;
7. Punëtorë të prodhimit të gurëve të mullirit.

XXIII. PUNA NË ARSIM-KULTURË

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:
1. Mësues dhe pedagog;
2. Drejtor shkolle;
3. Nëndrejtor shkolle dhe zëvendësdrejtor konvikti që zhvillon mësim në klasë;
4. Drejtor dhe instruktor i kabineteve metodike dhe ndihmësit e tyre;
5. Edukator, (kujdestar) i kopshtit, i shtëpisë së fëmijës, i konviktit dhe i shtëpisë së pionierit.

Drejtorët, instruktorët, shefat e seksionit në pallatin e pionierëve dhe shtëpitë e pionierëve dhe udhëheqësit e pionierëve në shkolla;

6. Drejtorët, inspektorët dhe ndihmësit për arsimin në aparatin e Këshillit të Ministrave, drejtorët dhe inspektorët në Ministrinë e Arsimit, përgjegjësit dhe inspektorët e seksioneve të arsimit në rrethe;
7. Drejtor dhe n/drejtor i kopshtit dhe shtëpisë së fëmijës;
8. Operator i filmave në kinostudio;
9. Shfuqizuar;
10. Shfuqizuar;
11. Artist i teatrove dramatike dhe i estradave profesioniste;
12. Dirigjent i orkestrës dhe estradës;
13. Regjisor dhe ndihmësregjisor i operës, teatrove dramatike, estradave, kinostudios dhe i shtëpisë së kulturës, regjisor, operator të Drejtorisë së Përgjithshme të Radiotelevizionit;
14. Baletmaestër dhe ndihmës i tyre, si dhe koreograf;
15. Kormaestër dhe ndihmës i tyre;
16. Shef muzike në shtëpinë e kulturës;
17. Trajnerë profesionistë efektivë të të gjitha kategorive të klubeve sportive.

XXIV. PUNA NË SHËNDETËSI

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Mjek kirurg (i të gjitha specialiteteve);
2. Mjek psikiatër;
3. Shfuqizuar;
4. Mjek anatomopatolog;
5. Mjek anestezist reanimator;
6. Punonjës i repartit të kobalto-terapisë.

XXV. PUNA NË BUJQËSI

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Mjek veterinar, pavarësisht nga sistemi ku punon (udhëzim i KM nr.4, datë 2.12.1987);
2. Punonjës i blegtorisë, që punon në izolatorë të ndryshëm të prekur nga sëmundje ngjitëse;
3. Eskavatoristë, buldozerist skreperist me traktorë me rusp;
4. Minator;
5. Manovrator i dragës lundruese.

XXVI. PUNA NË USHTRI

Punë e tillë quhet puna e kryer, si:

1. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm.

XXVII. PUNËT NË INDUSTRINË E BAKRIT

a) Në metalurgjinë e bakrit:

1. Punëtor vagonist i ngarkimit dhe transportit të lëndës së parë ndihmës në metalurgji;
2. Punëtor i brigadës së remontit dhe mirëmbajtjes së agregateve.
3. Inxhinier, teknik dhe përgjegjës i sektorit ose i turnit që punon direkt në metalurgjinë e bakrit.

b) Në rafinerimin e bakrit:

1. Murator i furrave të rafinimit të bakrit;
2. Punëtor pompist, vinçier, rrahës i fletëve ketodike dhe larës i shufrave në elektrolizën e bakrit;
3. Inxhinier, teknik dhe përgjegjës i sektorit që punon direkt në rafinimin me zjarr në elektrolizën, shkrirjen, larjen e tunxhit të bronxit dhe në përpunimin e shllameve.

c) Punët në uzinën e telave;

1. Punëtor i ngrohjes së kallëpëve të bakrit, ngarkesës së furrës, pritjes së kallëpeve të nxehtë, lidhjes e peshimit të katankës, deoksidues i katankës me H2S04, prodhim gurkali, pulti i komandimit në petëzimin e bakrit, zdruthues i kallëpëve, lubrifikues në petëzim, telëzues i telave të bakrit dhe aluminit;

2. Saldator i telëzimit të trashë, kallajisjes së telave përgatitjes së emulsit teknologjik, zmaltimit të telave, përgatitjes së llakut, regjenerimit të PVC, mekanik, elektrik i mirëmbajtjes në petëzim, zmaltim e telëzim;
3. Përgjegjës ndërrese në repartet e mësipërme.

XXVIII PUNËT NË INDUSTRINË KIMIKE

a)Në uzinën e nitrat amonit:
1. Punëtor i reaktorit në repartin e acidit nitrik;
2. Punëtor i krekingat;
3. Punëtor i desqufurimit, dekarbonatimit, larjes së bakrit, amoniakal, sintezës së amoniakut dhe shërbimeve të amoniakut;
4. Punëtor i kullës preling në repartin e nitrat amonit;
5. Punëtor i remontit dhe i mirëmbajtjes, si edhe përgjegjës i turnit që punon vazhdimisht në impiantet e përgatitjes së solucioneve arsenikale dhe të pastrimit të squfurit nga arseniku;
6. Punëtor i pastrimit të pusetave industriale dhe rrobalarës i repartit të përgatitjes së solucioneve arsenikale;
7. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në repartet e mësipërme;
8. Punëtor i prodhimit të uresë, qarkullimit, granulimit, destilimit, absorbimit dhe avullimit, punëtor i komprimimit të ajrit për aparatet e kontrollit matës, punëtor i remontit e mirëmbajtjes së makinerive e pajisjeve teknologjike në repartet e prodhimit të uresë dhe laborant i procesit teknologjik të prodhimit.

b) Në uzinën e superfosfatit:
1. Punëtor i furrës së djegies së piritit;
2. Punëtor i pastrimit të gazit, përgatitjes dhe absorbimit të acidit sulfurik.
3. Punëtor i pastrimit të elektrofiltrit dhe largimit të mbeturinave nga djegia e piritit;
4. Punëtor i copëtuesit të superfosfatit;
5. Punëtor i centrifugës të fluorisilikatit të natriumit;
6. Punëtor i remontit dhe mirëmbajtjes si dhe përgjegjësi i turnit që punon vazhdimisht në repartet e fluorosilikat natriumit, në absorbimin e gazrave të klorurit të përzierjes dhe pjekjes së superfosfatit dhe në repartin që punon me llak kundër antikorrozionit;
7. Përgjegjës turni ose brigadier që punon në prodhim në repartet e mësipërme.

c) Në uzinën e sodës kaustike
1. Punëtor i pastrimit të kolonave të bikarbonatit,
2. Ushqyes me sodë të kalcinuar i furrës së tharjes, ndihmës fugistit dhe punëtor i shnekëve në repartin e tharjes;
3. Pastrues i koncetratorëve dhe mbushës i sodës kaustike;
4. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhimin në repartet e mësipërme.

ç) Në ndërmarrjen e prodhimit të pesticideve.
1. Punëtor i bluarjes së squfurit, të oksidoklorifidit, të bakrit të përpunimit të lindanit,të prodhimit të zinepit, të TMTD, të vapamit e sulfatit të nikotinës;
2. Punëtor i prodhimit të sulfazolit, polisqufurit të kalciumit, të përpunimit dhe të përzierjes së lindanit;
3. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhimin në repartet e mësipërme;
4. Punëtor i mirëmbajtjes dhe i remontit, i kipit dhe antikorrozianit, kur punon vazhdimisht në repartet e mësipërme.

d) Në sektorë të tjerë kimikë:
1. Punëtor i elektrolizorëve në prodhimin e sodës kaustike;
2. Punëtor i furrës së karbitit dhe shpues i furrës:
3. Punëtor i prodhimit të nitratit-argjentit, sulfat-aluminit të sulfat-ferro-ferrikut dhe bikarbonatit;
4. Punëtor i prodhimit të gazit sulfuror dhe derivateve të tij;
5. Përgjegjës turni ose brigadier që punon direkt në prodhim në repartet e mësipërme.

dh) Në uzinën e PVC

1. Reparti i elektrolizës:
- punëtor i drejtimit të pultit të komandimit, përpunimit të ujrave me zhivë, të përpunimit e filtrimit të shëllirave, shllamit e sodës kaustike, pompist dhe të furnizimit me kripë. Përgjegjës ndërrese teknolog në repartin e elektrolizës.
2. Reparti i përpunimit të klorit:
- Punëtor operator i përpunimit të klorit, hidrogjenit, lëngështimit e mbushjes së klorit, absorbimit e debsorbimit, vëzhgues i furrës së sintezës, ambalazhimit të acidit klorhidrik, pompist i acidit klorhidrik dhe absorbues i klorit të pashfrytëzuar.
3. Sektori i hipokloritit:
- punëtor punimesh për përgatitjen kimike të gëlqeres, transportues me elevator i gëlqerores, absorbues prodhimi të hipokloritit, pompist i hipokloritit;
- mekanik mirëmbajtjes në repartin e përpunimit të klorit;
- përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e përpunimit të klorit.
4. Reparti i klorivinil polimer:
- punëtor i drejtimit të pultit të komandimit në konuertor në retifikim, punëtor konvertues, ratifikues.
5. Sektori i polimerit.
- punëtor i zbutjes së ujit filtrues e pompës, operator në sallën e komandimit, në punime kryesore në tharje, dekantues e përpunues në polimerizim, mbushës e paketues i PVC, punonjës në laboratorin e repartit të klorivinilit të polimerit;
- mekanik mirëmbajtës në repartin e klorivinil-polimerit;
- përgjegjës ndërrese, teknolog, në repartin e klorivinil-polimerit.
6. Reparti i oksigjen-ftohjes:
- punëtor në punime kryesore në kolonën e ratifikimit, kompresorist ajri, kompresorist azoti, kompresorist ajri të thatë, kompresorist oksigjeni, mbushës i bombolave të oksigjenit, ngarkim-shkarkimi i bombolave.
7. Sektori i ftohjes:
- punëtor në punime kryesore e ndihmës në drejtimin e sistemit -35°C;
- mekanik mirëmbajtje në repartin e oksigjenit të ftohtë;
- përgjegjës ndërrese, teknolog në repartin e oksigjenit të ftohtë.

XXIX. PUNËT NË PRODHIMIN E BATERIVE

1. Punëtor i axhustimit të rrjetave, i montimit dhe i trapanimit të zbërthimit të baterive;
2. Punëtor i heqjes së seperatorëve, i shkundjes së rrjetave dhe i thyerjes së antiamonit;
3. Përgjegjës turni që punon vazhdimisht në repart.

XXX. PUNËT NË UZINAT MEKANIKE, NË NDËRMARRJET METALIKE, ARTISTIKE DHE NË SEKTORË TË TJERË

Punë e tillë quhet puna e kryer gjatë gjithë ditës, si:
1. Punëtor i pastrimit kimik të metaleve;
2. Punëtor i furrave dhe banjave me kripëra kimike, helmuese;
3. Punëtore që punon në temperimin me frekuencë të lartë;
4. Punëtor i polerimit të artikujve metalikë;
5. Tornitor i punimit të metalit;
6. Punëtorët e prodhimit të enëve të emaluara;
7. Punëtorët në sektorët e xingimit.

XXXI. PUNËT NË FONDERI

1. Punëtor i përgatitjes së formave të shkrishme; udhëzimi nr.1, datë 24.3.1993 në të gjithë fonderitë.
2. Saldator i prerjes me gaz në fonderi
3. Punëtor i përpunimit termik të derdhjeve
4. Pultist i furrave elektrike dhe i pikave të përgatitjes së dheut.
5. Seleksionues dhe kontrollor operacional.
6. Vinçier në sektorët e pastrimit, të formimit dhe të saldimit.

7. Punëtorët e mirëmbajtjes mekanike, elektrike dhe hidraulike.
8. Përgjegjës turni dhe reparti.

XXXII. PUNËT NË KOMUNIKACION

1. Buldozerist dhe eskavatorist.

XXXII 1. PUNËT NË UZINËN E PETËZIMIT NË KOMBINATIN METALURGJIK NË ELBASAN

- Punët në metalurgjinë e zezë e ferrokrom:

a) Në uzinën e petëzimit:

1. Matës metali në të nxehtë;
2. Ngrohës metali;
3. Mbushës furre;
4. Makinist- nxjerrës i metalit nga furra;
5. Capinist;
6. Punëtor para makinës mbledhëse;
7. Kthyes kokash të metalit në të nxehtë;
8. Lidhës i produktit të gatshëm në procesin e prodhimit;
9. Shkarkues prodhimi;
10. Operator i pulteve të furrës, ai i pultit para makinës 650, operator i makinës mbledhëse dhe ai i pultit të furrës së petëzimit të imët;
11. Punëtor tranxhe e sharre në procesin e prodhimit në petëzimin e mesëm;
12. Pompist vaji (nëntokësor);
13. Punëtor i mirëmbajtjes dhe i remontit (mekanik, elektricist, hidraulik, kipist, oksigjenist, murator i teknologjisë, (axhustator i udhëzuesve);
14. Përgjegjës turni, njësie ose sektori, inxhinierë teknikë që punojnë drejtpërdrejt në repartet e petëzimit;
15. Punëtor i përgatitjes së peceve me fenol.

b) Punët në uzinën e nikel-kobaltit:

- përgjegjës ndërrese, teknolog reparti në repartet teknologjike të uzinës:

c) Në uzinën e gizës:

Në repartin e furrnaltës

- punëtor komandues dhe kontrollues i sistemit të ushqimit;
- punëtor të sistemit ftohës të furrnaltës;
- punëtor komandues dhe kontrollues i furnizimit të furrës nën bunker;
- punëtor të marrjes dhe përpunues të gazit të furrnaltës;
- punëtor të drejtimit të procesit teknologjik (drejtues e ndjekës të procesit teknologjik në furrnaltë);
- mekanik të sistemit hidraulik.

Në fabrikën e aglomerimit:

- punëtor të copëtuesit;
- punëtor të përziersit të parë dhe të dytë;
- punëtor të kontrollit të flakës;
- punëtor të sistemit ftohës;
- punëtor të transportierit nr.1,5,6,8,18 e kthim 22-23, 24,25,26,27, 28-29 me zinxhir dhe transportier nr.8 në objektin 226.

Reparti i lëndës së parë (furrnalta):

- punëtorët e sitave, komandues dhe ndihmëskomandues të copëtuesit komandues të sistemeve të transportierëve;
- punëtor të shërbimit në depo.

Në repartin e ajër - gazit:

- punëtor e ndihmës në komandimin e gazit;
- punëtor e ndihmës në ajërngrohës;
- punëtor në objektin 34;

- mekanik, elektricist, hidraulik që punojnë për mirëmbajtjen, riparimin dhe remontet e reparteve metalurgjike e kimike në uzinë;
- muratorë dhe ndihmësmuratorë të kovave të gizës;
- përgjegjës ndërrese, teknolog ndërrese në repartet teknologjike të uzinës;
- Shpëtuesit në uzinë.

d) Në uzinën e çelikut:

Në repartin e konvertave

- punëtorët e sistemit të ftohjes së gazit, punëtorë të pastrimit të gazit në konuertë dhe të sistemit të pastrimit të gazit në kovëlëkundje;
- vinçierë të aksit të skorjes (AB), vinçierë të aksit të shkrirjes së çelikut (reparti, furra elektrike me hark, shkrirje konverte, kovalëkundëse e mikser), vinçierë të aksit të derdhjes së çelikut (reparti furra elektrike me hark, konvertë, derdhja me konkilje, makina të derdhjes së pandërprerë, vinçierë, montim-çmontimi konkiljeje);
- punëtorët e transportierit të objektit 63 në repartin e konvertave;
- punëtorët e manovrimit të elektrodave në repartin e furrave elektrike me hark;
- punëtorë të zhbllokimit të konkiljeve, të repartit me gur zmeril të lingotave e prokateve të çelikut.

Në derdhjen e pandërprerë:

- punëtorë derdhës të rafinimit të çelikut lëng, derdhës i lubrifikimit të çelikut lëng, derdhës i ftohjes së prokatit, manovrator i drejtimit të prokatit dhe i pultit të komandimit;
- punëtorët e brigadës së pastrimit të mjediseve teknologjike në korpusin e çelikut, oksigjenistët e prerjes së kupolave e akrepit të ngurtësuar me rrymë oksigjeni;
- punëtor i zhbllokimit të kovave të skorjeve në korpusin e çelikut.

Në repartin e dolomit-gëlqeres:

- punëtorët në objektin 51 (të përgatitjes së kapakëve termoizoluese në derdhjen e çelikut, përziersit, pjekësit, formistët e kapakëve termoizoluese, copëtuesi me nofulla, punëtor në objektin 49, përzierësit dozuesit, përgatitësit e pluhurave egzotermike të prodhimit të lëngut të xhamit;
- punëtorë në objektin e prodhimit të tullave dolomite, përziersit e dolomitit, punëtoret e furrës ngrohëse, në presën e tullave në platformën vibruese, në objektin 48, trajtuesit, përgatitësit dhe copëtuesit e ferrolidhjeve.

Në punime të tjera:

Në repartin konvertë e furra elektrike me hark:

- murator dhe ndihmësmurator në konvertë, murator dhe ndihmësmurator në furra elektrike me hark, murator dhe ndihmësmurator kovëlëkundës, në kovat e derdhjes 25, kovat ndërmjetëse të derdhjes së pandërprerë, murator të miksterit, të remonteve të furrave metalurgjike, termike, kovave të gizës e çelikut;
- mekanik elektricist, hidraulik, frigoriferist që punojnë në mirëmbajtje e remonte të linjave, agregateve e pajisjeve metalurgjike, kimike e lëndëve të para;
- oksigjenistët e prerjes së metalit me kanellë;
- përgjegjës ndërrese, teknolog ndërrese në repartin e konvertave e furrave elektrike me hark.

dh) Në uzinën nr.l2:

Në repartin përgatitor:

- punëtor në repartin përgatitor (duke përjashtuar operatorin në sallën e komandës të objektit 102 dhe pompistët e objektit 128);
- makinist në sitat vibruese;

Në repartin e pjekjes:

- punëtorë në repartin e pjekjes (duke përjashtuar pompistët në kuotën zero dhe operatorët e sallave të komandimit të objekteve 124,127,129, pompistët e pompave të ujit objekti 125);
- teknolog të elektrofiltrave (elektricist, makinist, teknolog)

Në repartin e finjëzimit:

- gjithë punëtorët e repartit të finjëzimit.

Në repartin e koncentratit:
- gjithë punëtorët e këtij reparti, duke e përjashtuar sallën e komandës së objektit 225.
Në repartin e karburantit-bazik të nikelit:
- gjithë punëtoret e këtij reparti, duke përjashtuar teknologët në filtër presat.
Në repartin e gazit:
- gjithë punonjësit e repartit të gazit.
- punëtorë mekanikë, elektricistë, muratorë, punëtorë të përgatitjes së sulfatit të aluminit, të dërgimit të acidit sulfurik në repartet metalurgjike e kimike.
- përgjegjës e inxhinierë ndërresë në repartet metalurgjike e kimike.
a) Në uzinën koksokimike:
- makinist i vendosjes së koksit (rrampo);
- makinist i sitës së koksit;
- inxhinier ose teknik remonti në bateri;
- makinist e ndihmës i shtytësit të koksit;
- makinist e ndihmës i rrjetave drejtuese;
- teknolog i sallës së komandimit.
Në repartin e lëndës së parë:
- punëtor në transportierët nr.l, 3;
- punëtor të copëtuesit nr.l dhe 2.
Në repartin kimik:
- teknolog ventilimi, kryesor e ndihmës;
- teknolog kondensues;
- teknolog seturatori kryesor e ndihmës;
- centrifugist;
- teknolog tharësi e zëvendës;
- teknolog destilimi të benzolit, kryesor e ndihmës;
- teknolog i zbrazjes së squfurit;
- teknolog i tiosulfatit dhe sulfocianurit;
- teknolog i dërgimit të squfurit nga reaktori;
- teknolog i shkumës së squfurit;
- koncentrues i squfurit;
- punëtorë e manovrues fenoli, kryesor e ndihmës;
- punëtorë analizues fenoli;
- distilues katrani, kryesorë e ndihmës;
- manovrues kondensati;
- pompist katrani, benzoli, squfuri, ventilimi;
- punëtorë të brendshëm transporti teknologjik;
- shinashtrues në baterinë e koksit;
- mekanik, elektricist, hidraulik, në repartet metalurgjike, kimike e të lëndës së parë;
- përgjegjës dhe inxhinier ndërrese e reparti në repartet teknologjike.
f) Në uzinën e materialeve refraktare:
- punëtor në repartin përgatitor;
- punëtor në mullirin me sfera;
- punëtor në pompat pneumatike;
- punëtor në sitat vibruese;
- punëtor në mullirin unazor.
g) Në uzinën energjetike:
- Në repartin e kaldajave në TEC
- makinist i mullirit në kaldaja
Në repartin e lëndës së parë:
- punëtorë të transportierëve nr.1, 2,3,4,5,6,7,8, në sitën e qymyrit dhe copëtuesin e qymyrit.
Në repartin e oksigjenit:

- kompresorë e punëtorë mirëmbajtje në kompresorët centrifugalë të ajrit me prodhimtari 21000 m3 Nh dhe në kompresorët e oksigjenit me prodhimtari 3600 m3 Nh;
- mekanik, elektricist, hidraulik të mirëmbajtjes e remontit në repartin e kaldajave, në repartin e kompresorëve, repartin e lëndës së parë, në repartin e oksigjenit dhe të rrjetit inxhinierik në objektin 191;
- muratorët e remonteve të furrave e kaldajave;
- përgjegjës e teknolog ndërrese në TEC, në repartet e kaldajave e të lëndëve të para.

gj) Në repartin e inspektim shpëtimit nga gazi:
- shpëtuesit, komandanti dhe inxhinieri i repartit.

h) Në uzinat e ferrokromit:

1. Punëtorë të muratimit të kovave, veshjes së furrave e ulluqeve, thyerjes së ferrokromit, copëtimit e sitosjes, dozimit të lëndës së parë, të repartit të gazit e avaroshpëtuesit, punëtorë të mirëmbajtjes e remontit të furrave e pajisjeve teknologjike;
2. Punëtorë të seleksionimit të ferrokromit, manovrimit të sistemit hidraulik, elektrodave me rrymë të furrave të shkrirjes, përgjegjës reparti, ndërrese, teknolog në repartet e shkrirjes, gazit e bronzit.

XXXIII. PUNËT ME LËNDË RADIOAKTIVE DHE ME BURIME RREZATIMI JONIZUES

1. Punonjësit e laboratorit të rrezatimeve bërthamore dhe të njësive bërthamore, që janë në kontakt me lëndë radioaktive;
2. Rontgenolog, teknik rontgenolog, inxhinier rontgenolog, laborant rontgenolog në kabinete të rontgenologjisë;
3. Punëtorët e laboratorit që punojnë me rrezet "x" e ultratinguj në repartet teknologjike (rentgenolog, difektoskop) kampionmarrës dhe kryerës i analizave të gazit.

Shënim: për kategorizimin e punonjësve të repartit të koksit për efekt pensioni vendimi i Këshillit të Ministrave nr.273, datë 19.8.1977, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.254, datë 3.7.1980, kryeoperatori dhe operatori i impiantit të koksit, fugisti dhe ndihmësfugisti, punëtori i pastrimit të kazanëve të koksit dhe punëtori i remontit të impiantit të koksit, si dhe pompisti, ndihmëspompisti, arganisti, kompresoristi, punëtori i seleksionimit të koksit, muratori dhe saldatori, që kanë punuar në repartin e koksit për koksifikimin e bitumit të naftës në vitet 1965-1971, për efekt pensioni të përfshihen në kategorinë e dytë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.526, datë 20.12.1958.

XXXIV. PUNËT NË INDUSTRINË USHTARAKE

1. Në prodhimin e lëndëve eksplozive:
- punëtor i mbushjes së fishekëve me nitrat amoni dhe me trotil;
- rrobalarëse e teshave të punëtorëve që punojnë me trotil;
- mekanik, elektricist, kontrollor cilësie dhe seleksionues në repartin e prodhimit të lëndëve eksplozive;
- përgjegjës turni dhe teknolog që punon në repartin e mësipërm.

2. Në prodhimin e lëndëve plasëse iniciale:
- punëtor i prodhimit të zhivës ndezëse, nitrurit të natriumit, nitrurit të plumbit, timitrorezoricinatit të plumbit dhe tetrazenit;
- mekanik, elektricist, kontrollor cilësie dhe seleksionues që punojnë në repartin e mësipërm.

3. Në prodhimin e kapsollave detonatore:
- punëtor i përgatitjes së llak-shllakut, të llakurimit të detaleve, të fletës së kallajit, të letrës së pergamenit dhe të mëndafshit;
- punëtor i prodhimit të artikujve 873, 406, 541 dhe 542 (lëndë plasëse iniciale dhe trotil);
- punëtor i përgatitjes së llakut dnz, ak 20 dhe punëtor i llakërimit të fishekut bazë dhe të artikujve 571- CL, 573 - CI.

4. Në prodhimin e pilave:
- punëtor i përgatitjes së elektrolitëve dhe të pastës me klorur zhive; klorur amoni dhe klorur zingu;

- punëtor i ngopjes së letrës me elektrolit;
- punëtor i përgatitjes së përzierjes së aglomeratit;
- punëtor i ngjitjes me dorë të enëve të zingut me aliazh plumbi.

5. Në prodhimin e barutit:
- punëtor i bluarjes, i sitjes dhe i përzierjes së nitratit të kaliumit, squfurit dhe qymyrit për prodhimin e barutit;
- punëtor i poligonit të provave të arikullit 511.

6. Në prodhimin e fishekzjarreve:
- punëtor i prodhimit të fishekzjarreve.

7. Valë elektro-magnetike radioaktive:
- punëtor e teknik të akordimit dhe të kontrollit në stacionet radiaktive që punojnë me gjatësi radiovalësh shumë të shkurtëra dhe me fuqi të madhe.

8. Në Kombinatin e Poliçanit:
- punëtorët që punojnë në kontrolle me sy dhe montimin e shkrehësave, ata që punojnë në përgatitjen e gëzhojave të fishekëve bazë, përgatitjen e kallamave të gjuetisë dhe kutive të ndryshme;
- punëtorët që punojnë në injektimin e ultremidit e polietilenit, në proceset e trajtimit termik të detaleve;
- laborantët e reparteve ose linjave të larjes kimike galuanizimit dhe laborantet kimike;
- mirëmbajtësit e reparteve ku prodhohen artikuj luftarakë dhe reparteve të linjave të larjes kimike e galvanizimit;
- personeli inxhiniero-teknik e administrativ i uzinës dhe i reparteve e linjave që punojnë në sektorë e zona të reparteve dhe linjave të uzinës kimike;
- rrobalarëset e teshave të punëtorëve që punojnë në TNT;
- pastruesit e ujërave të zeza;
- punëtorët që punojnë në pastrimin me tallash e vajguri në baraban me larjen me benzinë;
- personeli tekniko-administrativ i sektorit të provave poligonale;
- punëtorët e mbushjes e të pastrimit të lëndës djegëse në plumbin e artikujve luftarake (fishekëve);
- punëtorët e sitjes së barutit;
- punëtorët e fosfatim-Ilakërimit, larjes përfundimtare dhe fosfatit me ndëroperacionale;
- punëtorët e montimit të fishekut dhe kapsollës;
- punëtorët që punojnë në vajra e solucione në linjat e përpunimit mekanik të municioneve;
- punëtorët e axhusterisë dhe të preçizionit të lartë;
- shoferët që transportojnë lëndë plasëse.

Shënim. Punët në industrinë ushtarake, që janë miratuar me vendimin nr.79, datë 28.5.1979, dhe që bien në kundërshtim me lidhjet nr.1 dhe nr.2 të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, shfuqizohen.

Kreu VI i pasqyrës nr.1 është i shfuqizuar.
Kreu X i pasqyrës nr.1 është shfuqizuar.

VENDIM
Nr. 1114, datë 30.7.2008

PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.05.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003, "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

(Ndryshuar me vendime të KM nr.1477, datë 12.11.2008; nr.376, datë 8.4.2009; nr.700, datë 18.6.2009; nr.1206, datë 11.12.2009; nr.477, datë 30.6.2010)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MBROJTJA DHE SIGURIMI I DETYRUESHËM

1. Në mbështetje të neneve 2, 7 dhe 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, quhen persona të mbrojtur:
   a) të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune, pa afat ose me afat më shumë se një muaj, që punojnë me kohë, të plotë ose të pjesshme, për më shumë se 87 orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurimin shëndetësor;
   b) të punësuarit me kontratë pune, me ose pa afat, por me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor;
   c) të punësuarit me kontratë pune, me afat më pak se një javë gjatë vitit, me kohë të plotë ose të pjesshme ditore, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivelin minimal, për aksidente në punë, sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor;
   ç) pronarët e personave juridikë, që ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë apo çdo funksion tjetër, të cilët si të punësuar pranë shoqërisë, sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente; në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor;
   d) personat fizikë, të vetëpunësuar, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, pavarësisht nga kohëzgjatja e saj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrëlindje, pensione dhe sigurim shëndetësor;
   dh) të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur:
      i) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në të njëjtin nënqark, ku kanë tokën, në pronësi ose në përdorim, dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrëlindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor;
      ii) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në fshat dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, edhe nëse kanë tokë, në pronësi

ose në përdorim, me vendndodhje në nënqarkun fqinj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për barrëlindje, për pensione dhe për sigurim shëndetësor;

e) pjesëtarët e familjes, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivel minimal, për barrëlindje, për pensione dhe sigurim shëndetësor;

ë) personat mbi 16 vjet, që punojnë në ndërtime të ulëta vetjake, sipas përcaktimeve në paragrafin e fundit, të nenit 20 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, për të cilat jepet leje nga komuna ose bashkia, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor;

f) personat fizikë, të vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, kur nuk janë të siguruar si punëmarrës ose si të vetëpunësuar në veprimtari ekonomike të vijueshme, sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, vetëm per degën e pensioneve. Si persona të vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, janë personat, që vetëpunësohen në veprimtari:

i) të përkohshme e të vijueshme, por pa një vend qëndrimi apo shërbimi, të përcaktuar;

ii) të përkohshme e me ndërprerje gjate javës, por pa një vend qëndrimi apo shërbimi, të përcaktuar;

iii) të vijueshme, në veprimtari tregtare në tezga, pa vend qëndrimi të përhershëm ose në mjete që lëvizin;

iv) të vijueshme, në veprimtari transporti, me ndërprerje gjatë javës;

g) të punësuarit, që punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si punëtorë shtëpie, në familjet e të tjerëve, sigurohen në mënyrë të detyrueshme vetëm për degën e pensioneve. Punëtorë shtëpie janë personat, që punësohen nga kryefamiljari, në punë të tilla, si kujdestar për fëmijët, kuzhinier, pastrues, roje-administrator shtëpie, asistent për të moshuarit etj., apo dhe në shërbime të ndryshme, të kësaj natyre.

2. Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, mbi 16 vjeç, të cilët paguajnë kontribut të detyrueshëm vetëm për sigurimin shëndetësor.

3. Nxënësit e shkollave të mesme apo profesionale, dhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore, të cilët sigurohen nga punëdhënësi vetëm për aksidentet në punë, për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet subjektit dhe institucionit përgjegjës.
Punëtorët e punësuar për herë të parë në një profesion të caktuar, në subjekte, që punojnë me material porositësi (fason), për kohën e programuar të formimit profesional, për të kryer punë të kualifikuara, në rastet kur punëdhënësi nuk përfiton financime nga zyra përkatëse e punësimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit profesional", sigurohen vetëm për aksidente dhe sëmundje profesionale.

4. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar, në subjekte të regjistruara për efekte fiskale në Republikën e Shqipërisë, mbrohen dhe sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në pikën "1" të këtij kreu.

5. Nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm përjashtohen shtetasit e huaj:

a) që punojnë në subjekte, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare;

b) pjesëtarë të subjekteve të huaja, që nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor;

c) me rezidencë të përhershme jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre, në të dyja shtetet, do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe

sigurimit të detyrueshëm, në atë vend, ku kanë rezidencën, vetëm nëse shteti i tyre ka një marrëveshje në fushën e sigurimeve shoqërore me shtetin shqiptar;

ç) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje, të lidhur me shtetin shqiptar.

II. PAGA BRUTO DHE PAGA MINIMALE

1. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

   Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nuk përfshihen:

   a) Përfitimet që punëmarrësi merr, në mënyrë të përhershme, nga fondet e sigurimeve shoqërore;

   b) kompensimet nga rritja e çmimeve;

   c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;

   ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykate;

   d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë për personat e punësuar sipas legjislacionit në fuqi;

   dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, e për veprimtari të shquara;

   e) vlera e shpenzimeve, për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit;

   ë) honoraret apo shpërblimet e tjera, të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 84 100 (tetëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë.

   Për të punësuarit, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, paga minimale mujore, për llogaritjen e kontributeve, është ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit nr.111 të ligjit të sipërpërmëndur, e cila nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale, e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike.

III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËRNDARJA E KONTRIBUTEVE

Në mbështetje të neneve 9, 10, 14 dhe 90 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 8, 9, 10, 11 e 12 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, llojet dhe masa e kontributeve përcaktohen si më poshtë vijon:

1. Shuma minimale mujore e kontributeve, për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 4693 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë. Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	%	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	51;
Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.4	235;
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3 633;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	51;
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	151;
Sigurimet shëndetësore	3.4	572.

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1177 (një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, për të punësuarin, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 27,9 % e pagës bruto mujore, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 16.7 % dhe pjesa e të punësuarit 11.2 %. Kontributet llogariten nga punëdhënësi, mbi pagën bruto, të përcaktuar në këtë vendim. Ai mban nga paga e punëtorit 9.5%, për sigurim shoqëror, dhe 1.7%, për sigurim shëndetësor, dhe, së bashku me pjesën e tij 15 % të pagës, për sigurim shoqëror, dhe 1.7% të pagës, për sigurim shëndetësor, e deklaron dhe e paguan në llogarinë bankare, të përcaktuar për kontributet.
4. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 26.7% të pagës bruto, sipas listë pagesës, ku pjesa e punëdhenësit të jetë 15.6 % dhe pjesa e të punësuarit 11.1 %, por jo më pak se niveli minimal i pagës bruto, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.
5. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 1 javë, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 3.7 % të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 2 % dhe pjesa e të punësuarit 1.7 %, por jo më pak se niveli minimal i pagës mujore, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.
6. I vetëpunësuari, i vetëpunësuari në ortakëri, i vetëpunësuari, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2010 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm, për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror, dhe 7 për qind, sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale, prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, të barabartë me 5 046 (pesë mijë e dyzet e gjashtë) lekë në muaj.
7. I vetëpunësuari, për pjesëtarët e familjes së tij, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2010 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror, dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, e barabartë me 5046 (pesë mijë e dyzet e gjashtë) lekë në muaj.
8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet, shoqërore e shëndetësore, për personat, që kryejnë ndërtime të ulëta vetjake të të tretëve, sipas përcaktimeve në paragrafin e fundit, të nenit 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998**,** duke filluar nga data 1.7.2008 e në vazhdim, do të jetë i njëjtë si edhe për të punësuarit e tjerë. Kontributet llogariten dhe paguhen në komunë ose bashki nga personi, i cili ka marrë lejen e ndërtimit.
9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të deklarojnë dhe paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 1 440 (njëmijë e katërqind e dyzet) lekë.
10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia, e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2010 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh.
11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 17 280 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 11 232 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë.
12. Të vetëpunësuarit në bujqësi nga data 1.7.2008 e në vazhdim, të derdhin kontribut mujor, për sigurimet e detyrueshme shëndetësore, në masën 5 për qind të shumës 5600 (pesë mijë e gjashtëqind) lekë në muaj, për zonat fushore, ndërsa në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, kontributi është në masën 3 për qind e shumës 5600 (pesë mijë e gjashtëqind) lekë në muaj.

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore, për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 1440 (një mijë e katërqind e dyzet) lekë në muaj.
14. Kontributi i detyrueshëm për aksidente dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit profesional, të personave të punësuar në subjekte, që punojnë me material të porositësit, të jetë 0.3 për qind e pagës bruto minimale, dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.

IV. PROCEDURAT PËR REGJISTRIM

1. Subjektet, përpara fillimit të veprimtarisë ekonomike edhe për efekte të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në organet tatimore apo në organet e pushtetit vendor, në përputhje me detyrimin për regjistrim, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi.
2. Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar, që e fillojnë veprimtarinë për herë të parë, paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm dhe regjistrimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave. Pas pajisjes së shtetasve me letërnjoftimin elektronik, numri i sigurimit shoqëror zëvendësohet me numrin personal të identifikimit.
3. Bashkitë ose komunat, që japin lejen për një ndërtim të ulët vetjak, në çastin e dhënies së lejes dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur, regjistrojnë veprimtarinë në emër të marrësit të lejes, i cili, me fillimin e punimeve, detyrohet të deklarojë punëmarrësit, të paraqesë listëpagesën mujore dhe të paguajë kontributet.
4. Personat e vetëpunësuar për herë të parë, në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm dhe regjistrimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave. Pas pajisjes së shtetasve me letërnjoftimin elektronik, numri i sigurimit shoqëror zëvendësohet me numrin personal të identifikimit.
5. Të vetëpunësuarit në bujqësi regjistrohen në agjencitë e sigurimeve shoqërore, pas paraqitjes së certifikatës së gjendjes civile dhe njërit nga aktet e mëposhtme:
   - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të komunës ose bashkisë;
   - Akt noterial, që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh. qiramarrje, etj.).

   Në çdo rast, aktet e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e lëshuar nga komuna, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari bujqësore / blegtorale.
6. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet, për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen si periudha sigurimi.

6.1 Njihen periudha sigurimi për efekt të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë":

a) periudhat nga data 1.10.1993 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi (21.12.2009), pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës;

b) periudhat nga data 1.9.1995 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi (21.12.2009), pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës, për rastet, kur toka është blerë, sipas ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", si dhe për rastet, kur toka është marrë me qira, me akt noterial;

c) periudhat nga data 1.9.1995 deri në datë 1.4.2006, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën 21.12.2009, të cilët vendbanimin e kanë në të njëjtin rreth ku kanë tokën, për rastet, kur toka është blerë, sipas ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", si dhe për rastet, kur toka është marrë me qira, me akt noterial.

Për njohjen e periudhave të sigurimit shoqëror, sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, të vetëpunësuarit në bujqësi, duhet të paraqesin këto dokumente:

i.Vërtetimin nga komuna/ bashkia se i interesuari ka tokë në pronësi ose në përdorim, duke cilësuar dhe datën, kur është përfituar kjo tokë.

ii.Certifikatën e gjendjes civile (në rastet e largimit, të shënohet dhe data e çregjistrimit nga regjistri i gjendjes civile).

iii.Vërtetimin nga komuna/bashkia se për këtë periudhë ka ushtruar veprimtari bujqësore e blegtorale.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr aktet për trajtimin e të gjitha kërkesave të refuzuara për pension, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Nuk është i detyrueshëm sigurimi dhe nuk mund të llogariten detyrimet e kontributeve e të kamatëvonesave për pjesëtarët e familjeve bujqësore, të vetëpunësuar në bujqësi, për periudhën, që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas ligjit nr.7710, datë 18.5.1995 "Për ndihmat dhe përkujdesjen shoqërore". Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.
8. Kryefamiljarët, që punësojnë persona, si punëtorë shtëpie, i rregullojnë marrëdhëniet e punës, nëpërmjet një kontrate me shkrim, ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave shënohen, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj "me ose pa afat", si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe si i tillë ka detyrimin për regjistrim në organet tatimore dhe për pajisjen nga këto organe me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i). Regjistrimi dhe çregjistrimi nga organet tatimore bëhen sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet me udhëzim nga Ministri i Financave.
9. Formimi profesional nëpërmjet punës, për kualifikimin e punëmarrësit në një profesion të caktuar, të domosdoshëm për veprimtarinë ekonomike, realizohet nga punëdhënësi. Pjesëmarrja në trajnim, në rastet kur është parashikuar vetëm sigurimi për degën e aksidentit në punë, lejohet vetëm një herë dhe jo më shumë se tre muaj, për një person. Koha e programuar e formimit profesional nëpërmjet punës, lloji i kualifikimit dhe lista e personave pjesëmarrës deklarohen zyrtarisht në zyrën përkatëse të punësimit, përpara fillimit të trajnimit.

V. PAGESA E KONTRIBUTEVE

1. Pagesa e kontributeve dhe interesave të lidhura me to kryhet nga punëdhënësit dhe nga të vetëpunësuarit, sipas afateve të përcaktuara me ligj. Dokument bazë për pagesën e tyre është deklarata, njoftim i rivlerësimit dhe çdo dokument tjetër ligjor, i miratuar për këtë qëllim.
2. Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësit, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute gjatë të gjithë kohës, që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës.
3. Për rastet kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose me shumë subjekte, pagesa e kontributit është e detyrueshme në çdo subjekt, sipas pagës, por jo më shumë se kontributi maksimal. Rregullat e llogaritjes së pagesës dhe të rimbursimeve të kontributit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.
4. Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore individualisht, një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.
5. E shfuqizuar.
6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore furnizon punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit me librezat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Punëdhënësi i pajis të punësuarit me librezën e kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, të cilën e plotëson çdo muaj, në datën e pagesës së pagës mujore. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, libreza e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat vendore, të autorizuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
7. Për personat e përcaktuar në pikën 8 të kreut III të këtij vendimi, kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, vilen dhe transferohen në llogaritë bankare, të përcaktuara për

kontributet, nga bashkitë ose komunat, të cilat administrojnë edhe dokumentacionin përkatës. Procedurat caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

8. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante pajisen me librezën e kontributit të sigurimit shoqëror, nga struktura e sigurimeve shoqërore, e cila është e detyruar ta plotësojë atë në bazë të kontributeve të paguara. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, në bazë të të njëjtave rregullave si pagesa e kontributeve nga personat e tjerë, të vetëpunësuar në biznesin e vogël.
9. Në tremujorin pasardhës, të vetëpunësuarit, pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante dhe të vetëpunësuarit në bujqësi, vlerësohen të siguruar, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës.
10. Kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas këtij vendimi, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, paguhen nga kryefamiljari, i përcaktuar si punëdhënës, në llogaritë bankare, të përcaktuara sipas procedurave, të vendosura për këtë qëllim. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, sipas rregullave për pagesat e kontributeve nga personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël. Këta persona, sikurse dhe personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbim, ambulante, pajisen me librezën e kontributit, nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyruara ta plotësojnë në vijimësi, në bazë të kontributeve të paguara, dhe vlerësohen të siguruar, për efekt mbrojtjeje nga sigurimet shoqërore, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës. Në këtë rast në librezë shënohet "Të siguruar vetëm për pension".

VI. PROCEDURAT E KALIMIT TË KONTRIBUTEVE DHE MBLEDHJA E BORXHEVE

1.Kontributet paguhen në llogaritë bankare, të përcaktuara për këtë qëllim, të çelura në bankat e nivelit të dytë, apo edhe nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a., për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila është përgjegjëse për administrimin e këtyre llogarive si për të gjitha llogaritë e tjera, për të ardhurat tatimore.

2. Bankat e nivelit të dytë, në fund të çdo dite, raportojnë në mënyrë të hollësishme, në Bankën e Shqipërisë, për gjendjen progresive të këtyre llogarive, për të cilën njoftohet, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Procedurat e evidentimit, të njoftimit dhe të kalimit të kontributeve në llogaritë e fondit të sigurimeve shoqërore dhe në fondin e sigurimeve shëndetësore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare paguhen në llogaritë bankare apo në zyrat e Postës Shqiptare, sh.a., sipas marrëveshjeve, ndërmjet tyre dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

4. Kontributet e papaguara në afatet e përcaktuara vlerësohen detyrim ndaj fondit të sigurimeve shoqërore.

5. Për subjektet juridike dhe fizike, përveç personave të vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e interesave llogaritet, evidentohet dhe administrohet nga administrata tatimore, e cila është përgjegjëse edhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, që këto subjekte kanë ndaj sigurimeve shoqërore. Për subjektet debitore aktivë me detyrime të prapambetura në organet e sigurimeve shoqërore dhe të paarkëtuara deri më 1.7.2010 të bëhet transferimi i detyrimeve të prapambetura të tyre në organet tatimore.

6. Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e kamatëvonesave llogaritet nga administrata e sigurimeve shoqërore. Dokument bazë për llogaritjen dhe evidentimin e tij është aktdetyrimi tip, ku, përveç të dhënave të tjera, shënohet edhe pronësia mbi tokën, sipas zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Aktdetyrimi hartohet nga administrata e sigurimeve shoqërore, jo më vonë se një muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve. Shuma e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat evidentohet në kontabilitetin e sigurimeve shoqërore.

VII. RAPORTIMI DHE EVIDENTIMI I KONTRIBUTEVE INDIVIDUALE

1.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj dërgojnë, çdo muaj, në strukturat përkatëse të sigurimeve shoqërore, në strukturat e sigurimeve shëndetësore dhe në Institutin e Statistikave (INSTAT):

a) Për sigurimet shoqërore:

i. Të dhënat për kontributet dhe interesat e paguara, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur janë kryer, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesat në llogaritë bankare.

ii. Formularin përmbledhës të listëpagesave, sipas subjekteve, deri në datën 25 të muajit pasardhës, të muajit kur është realizuar, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesa e kontributit.

iii. Listëpagesat origjinale, sipas formatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, deri në datën 28 të muajit pasardhës, të muajit kur është paraqitur deklarata. Për subjektet fizike, për afatin e depozitimit të listëpagesave, shtohen 10 ditë.

iv. Listëpagesat, në format elektronik, dhe përmbledhësja për deklarimin e të dhënave të listëpagesës, sipas afateve dhe përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave.

v. Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve aktive, numrin e kontribuesve dhe shumën e kontributeve, mujore dhe progresive, sipas formatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

vi. Të dhënat mujore për detyrimet për kontributet e papaguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët, për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur deri në datën 28, të muajit pasardhës dhe deri në datën 28 të muajit pasardhës, pas mbylljes së tremujorit, për të vetëpunësuarit privatë, sipas formatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

b) Për sigurimet shëndetësore:

i. Të dhënat për kontributet dhe interesat e paguara, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur janë kryer, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesat në llogaritë bankare.

ii. Formularin përmbledhës të listëpagesave, sipas subjekteve, deri në datën 25 të muajit pasardhës, të muajit kur është realizuar, zyrtarisht dhe në format elektronik, pagesa e kontributit.

iii. Të dhënat për kontributet individuale, të paguara nga personat e siguruar. Procedurat e identifikimit të personave të siguruar dhe të pagesave të kontributeve gjatë periudhës, caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

iv. Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve.

c) Për Institutin e Statistikave (INSTAT):

1. Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarisë, që ushtrojnë.

2. Strukturat, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dërgojnë në strukturat përkatëse të sigurimeve shëndetësore, zyrtarisht dhe në format elektronik, të dhënat për kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe interesat e paguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, deri në datën 10 të muajit pasardhës, të muajit kur është derdhur kontributi.

3. Kur nuk ka të dhëna, për shkak të mosdorëzimit nga tatimpaguesit të deklaratave apo të listëpagesave, administrimi bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36, e 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë, të këtij neni, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 6980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën

e fundit të sigurimit si të vetëpunësuara në bujqësi, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 6 980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

IX. PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Përfitimet afatshkurtra për sëmundje, barrëlindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, në favor të të punësuarit, llogariten nga punëdhënësi, ndërsa për personat fizikë, nga strukturat vendore të sigurimeve shoqërore. Fondet për mbulimin e këtyre pagesave transferohen nga llogaritë e sigurimeve shoqërore në llogarinë e personit juridik apo fizik, ose në llogarinë individuale të përfituesit, pranë bankave të nivelit të dytë, një herë në muaj, pas miratimit nga administrata e sigurimeve shoqërore të listëpagesës. Procedura e kontrollit dhe e miratimit të llogaritjeve përcaktohet me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
2. Përfitimet mujore afatgjata u paguhen përfituesve, nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a., dhe bankave të nivelit të dytë. Rregullat dhe procedurat e pagesës përcaktohen me marrëveshje, ndërmjet palëve.
3. Kështet mujore të pensioneve dhe të përfitimeve të tjera, që llogariten nga administrata e sigurimeve shoqërore, u paguhen përfituesve, në total, në shuma të plota dhjetëlekëshe, duke rrumbullakosur vetëm shifrën e fundit. Kur shifra e fundit është mbi 5, bëhet 10, dhe kur shifra e fundit është më e vogël se 5, bëhet zero. Rrumbullakimi, sipas rastit, zbatohet në kolonën, ku evidentohet shuma e pensionit.

X. BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE

1. Marrëdhëniet administrative e financiare, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare sh.a., rregullohen me akte nënligjore dhe me marrëveshje të përbashkëta.
2. Procedurat e regjistrimit dhe të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për kategori të veçanta personash realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila, në varësi të veprimtarisë ambulatore apo të veçantë, lidh marrëveshje bashkëpunimi edhe me organe të tjera shtetërore.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kontrollon edhe dokumentacionin, që vërteton pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga personat, e punësuar dhe të vetëpunësuar në veprimtari transporti. Kjo drejtori nuk do të ofrojë asnjë shërbim nëse drejtuesit e mjeteve nuk kanë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore dhe ato tatimore.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të nxjerrin udhëzimet e nevojshme, në zbatim të këtij vendimi.

2. Vendimet nr.771, datë 13.11.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë", dhe nr.167, datë 29.3.2006 "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 8.8.2008

VENDIM
Nr.285, datë 4.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË, TË PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007" dhe të nenit 36 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur administrata tatimore vëren se pagat e deklaruara nga punëdhënësit jopublikë, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale të të punësuarve të tyre, nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen vlerës së tregut për shërbimet e punësimit, ajo ka autoritetin t'i rivlerësojë, sipas niveleve të pagave, të dhëna në këtë vendim.

2. Paga referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e teknikoekonomik, sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, përcaktohet në seksionet A deri në O dhe në nënndarjet, sipas klasifikimit në tri kategori të rretheve, ku ushtrohet veprimtaria e biznesit (tabelat, që i bashkëlidhen këtij vendimi). Për degët e naftës, hotelerinë dhe peshkimin administrata tatimore mund të zbatojë pagën referuese të pozicionit "Administrator/drejtor i përgjithshëm" të rrethit të Tiranës, për të njëjtin pozicion për subjektet, që ushtrojnë veprimtari në rrethet e kategorisë së dytë e të tretë.

3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

a) "Punë e pakualifikuar apo me kualifikim të ulët" punët, që nuk kërkojnë kualifikim paraprak apo që mund të kryhen nga një punëmarrës, i cili mund të mos e ketë kryer ndonjëherë atë punë. Këtu përfshihen, pa u kufizuar vetëm në to, punë të tilla, si pastrues, korrier, shitës, kamerier, paketues, lavazhier, përgatitës llaçi me krahë, transportues me krahë, punëtor ngarkim-shkarkimi me krahë, punëtor për gërmim toke me krahë, qepës cope e lëkure, si dhe punëtorë për punë të ngjashme.

b) "Punë e kualifikuar" punët apo profesionet, që kërkojnë aftësim profesional dhe që nuk mund të kryhen nga një punëmarrës pa kualifikim paraprak apo që nuk e ka ushtruar ndonjëherë atë punë a profesion. Njohuritë e shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar, për një specialitet të dhënë, mund të jenë fituar nga punëmarrësi përkatës, nëpërmjet arsimit profesional, kurseve të formimit profesional apo dhe gjatë praktikës. Punëmarrësit, që punojnë në punë të kualifikuara, si:

- Në sektorin e ndërtimit (murator, karpentier, suvaxhi, shtrues pllakash, bojaxhi, betonues, izolues, zdrukthëtar ndërtues, montator, saldator, hidraulik, elektricist etj., të krahasueshme).
- Në sektorin e industrisë së veshjeve dhe atë të lëkurës e këpucëve (modelist, prestar, lustrues etj., të krahasueshme).
- Në sektorin e prodhimit të mobilieve (modelist, zdrukthëtar, tapicier, mobilist, lustrues etj.).
- Në sektorin e ushqimit social (recepsionist, kuzhinier, banakier, pastiçier, picier etj., të krahasueshme).
- Në sektorin e medieve (reporter, gazetar, kameraman etj., të krahasueshme).

Nuk mund t'i kryejnë këto punë e profesione, nëse nuk kanë kryer, paraprakisht, një shkollë profesionale, një kurs formimi profesional apo nuk e kanë përfituar këtë profesion gjatë praktikës.

3	Fabrika te perp. te mineraleve	3,293
4	Nafta	3,348
5	Gjeologjia	0
	Nentoke	3,420
	Siperfaqe	3.348
6	Metalurgjia me ngjyre	3,304
7	Metalurgjia e zeze	3.392
8	Kimia	3,304
9	Qelqi	3,348
10	Sharrat	3,277
11	Material ndertimi, tulla, çimento	3,107
12	Mekanike elektrike	2,795
13	Druri, letra	2,795
14	Lekure - Goma	3,222
15	Tekstil - Trikotazh	2,965
16	Ushqimore	2,707
17	Kepuce - Konfeksione	2,795
18	Duhani	2,893
19	Peshkimi	4.110
20	Bujqesi, pyjet	2,833
21	Blegtori	2,899
22	Tipografia	3,063
23	Tregti - Grumbullim	2,740
24	Ushqim Social	2,466
25	Ndertimi	3.063
26	Mekanizmat e renda	4,110
27	Shofere transporti	3,233
28	Punetore porti	3,420
29	Poste telekomunikacion	2,921
30	Mirembajtje rruge	2,904
31	Transporti hekurudhor	3,562
32	Komunale	2,965
33	Punetore te tjere	2,685

VENDIM
Nr.590, datë 31.8.2006

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.9588, DATË 25.7.2006 "PËR RILLOGARITJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve", pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 1.1.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual por, në çdo rast, brenda periudhës 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

2. Indeksimi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve".

3. Rillogaritja e masës së pensionit dhe indeksimet bëhen në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në dosjen individuale të pensionit dhe mbi të cilat është caktuar masa e pensionit fillestar.

II. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005.

1. Në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 "Për rillogaritjen e pensioneve", pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë, u rillogaritet baza e vlerësuar, sipas nenit 59, dhe u indeksohet paga neto, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, përdoren pagat referuese, të përcaktuara në vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve".

3. Nga data 1.1.1994 dhe deri më datën e fillimit të pensionit këto paga do të indeksohen me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, të përcakuara në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve".

4. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 dhe deri në datën e fillimit të pensionit, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, merren pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, të indeksuara me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve".

5. Paga neto e tri viteve rresht, në dhjetë vitet e fundit të punës, rillogaritet duke përdorur të njëjtët koeficientë indeksimi, si edhe për rillogaritjen e bazës së vlerësuar.

6. Periudhat e sigurimit pas datës 1.10.1993, të njohura të vlefshme për efekt llogaritjeje pensioni, por të pashoqëruara në kohën e caktimit të pensionit me dokumentin që vërteton pagën për çdo muaj, duke u bazuar në nenin 60 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në nivel minimal.

III. Masa e re e pensionit, e rillogaritur sipas krerëve I dhe II, të këtij vendimi, rritet radhazi, sipas përqindjeve të rritjes së pensioneve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, për rritjen e pensioneve, por, në çdo rast, për periudhat nga data e caktimit të pensionit

individual e deri në datën 1.7.2006, përfshirë edhe rritjen e caktuar me vendimin nr.399, datë 21.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pensioneve".

Masa e pensionit, që rezulton pas rillogaritjeve dhe zbatimit të rritjeve, është masa përfundimtare e pensionit individual. Kur kjo masë pensioni rezulton më e vogël se pensioni ekzistues, atëherë nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

IV. Efektet financiare, për vitin 2006, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 465 000 000 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, nga të cilat 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë shpenzime administrative, dhe përballohen nga fondi i kontigjencës së Këshillit të Ministrave dhe nga fondet shtesë, të përcaktuara në ligjin nr.9601, datë 28.7.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006"".

V. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.96, datë 8.9.2006

VENDIM
Nr.642, datë 11.6.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2008	1.00;
Për vitin 2007	1.11;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet, që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2009, dhe përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.1628, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.106, datë 17.7.2009

VENDIM
Nr.1628, datë 17.12.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2007	1.00;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet, që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2008 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.731, datë 7.11.2007 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.12.2008

VENDIM
Nr.731, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2006	1.00;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2007 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.400, datë 21.6.2006 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.154, datë 19.11.2007

VENDIM
Nr.400, datë 21.6.2006

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2005	1.00;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, e që janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2006, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.374, datë 31.5.2005 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 5.7.2006

VENDIM
Nr.374, datë 31.5.2005

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin	2004	1
Për vitin	2003	1.1
Për vitin	2002	1.09
Për vitin	2001	1.14
Për vitin	2000	1.07
Për vitin	1999	1.09
Për vitin	1998	1.05
Për vitin	1997	1.22
Për vitin	1996	1.09
Për vitin	1995	1.37
Për vitin	1994	1.32

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që janë vetëm për pensionet që përcaktohen në vitin 2005 e që fillojnë nga data 1.1.2005, të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.357, datë 1.6.2004 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 13.6.2005

VENDIM
Nr.357, datë 1.6.2004

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2003	1
Për vitin 2002	1.09
Për vitin 2001	1.14
Për vitin 2000	1.07
Për vitin 1999	1.09
Për vitin 1998	1.05
Për vitin 1997	1.22
Për vitin 1996	1.09
Për vitin 1995	1.37
Për vitin 1994	1.32

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe fillojnë nga data 1.1.2004.

3. Vendimi nr.295, datë 8.5.2003 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e koeficientit të indeksimit të bazës mesatare të vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensionit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.42, datë 23.6.2004

VENDIM
Nr.295, datë 8.5.2003

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS MESATARE TË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët për indeksimin e bazës mesatare të vlerësimit vjetor, individual, që personat e siguruar e kanë realizuar nëpërmjet pagimit të kontributeve, për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për Vitin	2002	1
Për Vitin	2001	1.14
Për Vitin	2000	1.07
Për Vitin	1999	1.09
Për Vitin	1998	1.05
Për Vitin	1997	1.22
Për Vitin	1996	1.09
Për Vitin	1995	1.37
Për Vitin	1994	1.32

2. Efektet financiare, që lidhen në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.258, datë 13.6.2002 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual për llogaritjen fillestare të pensionit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, datë 30.5.2003

VENDIM
Nr.258, datë 13.6.2002

PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët për indeksimin e bazës mesatare vjetore, të vlerësueshme, individuale, që

personat e siguruar kanë realizuar nëpërmjet pagimit të kontributeve, për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin	2001	1
Për vitin	2000	1.07
Për vitin	1999	1.17
Për vitin	1998	1.22
Për vitin	1997	1.49
Për vitin	1996	1.63
Për vitin	1995	2.23
Për vitin	1994	2.94

2. Efektet financiare që lindin në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuara në pikën 1, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.360, datë 27.5.2001 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensionit" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.27, datë 21.6.2002

VENDIM
Nr.360, datë 27.5.2001

PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Koeficientët e shtesës së bazës të vlerësuar vjetore, individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3 të nenit 59 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 të jenë:

Për vitin 20001
Për vitin 19991x1.09=1.09
Për vitin 19981x1.05=1.14
Për vitin 19971x1.22x1.09=1.40
Për vitin 19961x1.09x1.22x1.05x1.09=1.52
Për vitin 19951x1.37x1.09x1.22x1.05x1.09=2.09
Për vitin 19941x1.32x1.37x1.09x1.22x1.05x1.09=2.75

2.Efektet financiare, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientit të përcaktuar në pikën 1, të përballohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, i programuar për vitin 2001.

3. Vendimi nr.159, datë 7.4.2000 i Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2001.

KRYEMINISRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, datë 19.6.2001

VENDIM
Nr.159, datë 7.4.2000

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 32 dhe 59, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvëndëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e shtesës së bazës së vlerësuar vjetore, individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703. datë 11.5. 1993, të jenë

Për vitin 1999	1
Për vitin 1998	1.05
Për vitin 1997	1x1.05x1.22 = 1.28
Për vitin 1996	1x1.05x1.22x1.09 = 1.40
Për vitin 1995	1x1.05x1.22x1.09x1.37 = 1.91
Për vitin 1994	1x1.05x1.22x1.09x1.37x1.32 = 2.53

2. Efektet financiare, në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1, të përballohen nga fondi i miratuar për vitin 2000 për Insitutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.388, datë 19.8.1999, i Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2000.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, datë 10.5.2000

VENDIM
Nr.388, datë 19.8.1999

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale,

KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDOSI:

1. Koeficientët e shtesës së bazës të vlerësuar vjetore individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3 të nenit 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të jenë:

Për vitin 1998 koeficienti do të jetë 1
Për vitin 1997 koeficienti do të jetë 1 x 1.22 = 1.22
Për vitin 1996 koeficienti do të jetë 1 x 1.09 x 1.22 = 1.32
Për vitin 1995 koeficienti do të jetë 1 x 1.37 x 1.09 x 1.22 = 1.82

Për vitin 1994 koeficienti do të jetë 1 x 1.32 x 1.37 x 1.09 x 1.22 = 2.4

2. Efektet financiare që lindin në momentin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1, të përballohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, i programuar për vitin 1999.

3. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1999

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.726, datë 19.11.1998 "Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, datë 5.10.1999

VENDIM
Nr.726, datë 19.11.1998

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e shtesës së bazës së vlerësueshme vjetore, individuale për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3 të nenit 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të jenë:

-Për vitin 1997 koeficienti të jetë 1
-Për vitin 1996 koeficienti të jetë 1 x 1.09 = 1.09
-Për vitin 1995 koeficienti të jetë 1 x 1.09 x 1.37 =1.49
-Për vitin 1994 koeficienti të jetë 1 x 1.09 x 1.37 x 1.32 =1.97

2. Organet e sigurimeve shoqërore, për pensionet me datë fillimi 1.1.1997 e në vazhdim, që janë në veprim, të rillogarisin masën e pensionit duke shtuar bazën e vlerësueshme, individuale për vitet e sipërme me koeficientët e pikës 1. Për pensionet e mbyllura, të caktuara me datë fillimi 1.1.1997 e në vazhdim, rillogaritja do të bëhet vetëm me kërkesën e të interesuarit ose të familjarëve.

3. Efektet financiare për mbulimin e shtesës së masës së pensioneve, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të pikës 1, të përballohen nga fondi i ISSH-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.XII, 2003

VENDIM
Nr.249, datë 5.6.1992

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Në mbështetje të neni 4 të ligjit "Për sigurimet shoqërore shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në vartësi të Këshillit të Ministrave, si institucion shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kryerjen e funksioneve të tij, mbështetet në ligjin "Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore" dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka këto detyra e të drejta:

- Drejton, organizon dhe kontrollon për zbatimin unik e të njësuar të ligjshmërisë në fushën e marrëdhënieve të sigurimeve shoqërore për punëtorët, nëpunësit dhe subjektet private, pavarësisht nga format e organizimit të tyre.
- Mbron interesat dhe të drejtat e punonjësve e të pensionistëve në fushën e sigurimeve shoqërore.
- Kryen studime të rëndësishme shkencore në fushën e sigurimeve shoqërore dhe punon për përmirësimin dhe përsosjen e vazhdueshme të legjislacionit në përputhje me mundësitë ekonomike.
- Nxjerr akte nënligjore për organet e tij vartëse, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave të dhëna për zbatimin sa më drejt të ligjshmërisë në këtë fushë.
- Drejton, ndihmon dhe kontrollon organet e saj vartëse në rrethe për përsosjen e organizimit e të drejtimit të punës, zbatimin e ligjshmërisë e të kompetencave në këtë fushë dhe forcimin e kontrollit dhe rritjen e efektivitetit.

4. Instituti i sigurimeve Shoqërore është person juridik me qendër në Tiranë, i cili drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori.

5. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ushtron veprimtarinë e tij ekonomike dhe financiare në mënyrë të pavarur. Me të ardhurat që realizohen nga kontributi që derdhin subjektet e siguruara dhe financimi buxhetor, përballon shpenzimet që përfitojnë punonjësit nga ligji i sigurimeve shoqërore. Teprica e fondeve që rezultojnë në fund të çdo periudhe, nuk derdhet në buxhetin e shtetit, por mbahet për periudhën pasardhëse.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka këto organe:

a) Drejtorin.

b) Këshillin Administrativ.

Kompetencat e këtyre organeve përcaktohen në statutin e institutit dhe në rregulloren e brendshme të tij, që miratohen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka aparatin e tij dhe organet vartëse në rrethe, që janë drejtoritë e sigurimeve shoqërore, të cilat varen dhe kontrollohen nga ky institucion.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.3, datë 14.7.1992

VENDIM
Nr.161, datë 11.4.1994

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 78 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrit të Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.391, datë 3.9.1992 "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.69, datë 24.9.2010

STATUTI
I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

KREU I
KRIJIMI DHE VENDI

Neni 1

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që më poshtë do të quhet ISSH, është institucion publik shtetëror i pavarur. Veprimtaria e tij rregullohet me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 " Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

ISSH është person juridik shqiptar me qendër në Tiranë. Ai operon me zyrat rajonale dhe agjencitë lokale, që veprojnë në gjithë vendin.

KREU II
FONDET THEMELORE, BURIMET E FORMIMIT DHE PËRDORIMI I TYRE

Neni 3

ISSH administron fondin e sigurimeve shoqërore në mënyrë të pavarur. Të ardhurat realizohen dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 " Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4

Fondi i ISSH administrohet në pesë degë të veçanta:
- Dega e sigurimit për sëmundje.
- Dega e sigurimit për barrëlindje.
- Dega e sigurimit për pensione.
- Dega e sigurimit për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale.
- Dega e sigurimit të papunësisë.

Krijohet llogari e veçantë për mbulimin e shpenzimeve administrative.

Nuk lejohet transferimi i fondeve midis degëve të sigurimit shoqëror.

Transferimet lejohen vetëm në rastet e parashikuara në ligj për pagesën e kontributeve e të shpenzimeve administrative.

Neni 5

ISSH krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave që nevojiten për të përballuar të paktën 3 muaj shpenzimet për pensione.

KREU III
VEPRIMTARIA E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Neni 6

Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore përfshin:

a) arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga derdhja e kontributit të ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe subjekteve private, pavarësisht nga forma e organizimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;

b) pagimin e përfitimeve të sigurimeve sipas dispozitave ligjore;

c) investon fondin rezervë, me qëllim që të rritet fitimi i ISSH.

Neni 7

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet organeve të tij vartëse në rajon e qytete, kryen veprime për sigurimin e detyrueshëm të punonjësve, si dhe cakton masën e ndihmës a të pensionit në bazë të dokumenteve që paraqesin ndërmarrjet, institucionet, organizatat ose vetë të siguruarit.

Sigurimet për sëmundje, lejen e barrëlindjes, ndihmat për lindje fëmije, shpenzimet e varrimit dhe pensionet e invaliditetit të pjesshëm për punonjësit e sektorit shtetëror paguhen nga ndërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore etj., për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, kurse për punonjësit e sektorit privat nga agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Ndihmat për lindje fëmije dhe shpenzimet e varrimit për pensionistët paguhen nga organet e sigurimeve shoqërore.

Pensionet e të gjitha llojeve paguhen nga agjencitë bankare për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, sipas kontratës që lidhet, ku përcaktohet edhe masa e komisionit.

Neni 8

ISSH, për shërbimet që u bëhen personave të siguruar, mban shpenzimet e kryera të barabarta me vlerën e materialit të shpenzuar nga ky institucion.

KREU IV
KONTABILITETI DHE BILANCI I ISSH

Neni 9

Viti financiar i ISSH-së është vit kalendarik 1 janar gjer më 31 dhjetor.

Neni 10

ISSH mban regjistrat dhe librat në përputhje me ligjin dhe rregulloren financiare.

Neni 11

ISSH përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton planin financiar të vitit ushtrimor.Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga Këshilli Administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten çdo vit, nëpërmjet Ministrit të Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Këshilli administrativ miraton komisionin e kontrollit për revizionimin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Zyrat rajonale kontrollohen nga sektori i kontroll-revizionit në ISSH, kurse agjencitë nga sektori i kontroll-revizionit të zyrave rajonale; revizioni kryhet në përputhje me rregulloren financiare të ISSH.

KREU V
DREJTORI DHE ADMINISTRIMI I ISSH

Neni 13

Drejtimi dhe administrimi i ISSH-së kryhet nga:

a) këshilli administrativ;

b) drejtori i përgjithshëm.

Këshilli administrativ është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 12 anëtarë të caktuar: 6 nga Këshilli i Ministrave, të cilët do të jenë përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Kursimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore; 3 anëtarë nga organizatat e punëdhënësve (në kushtet e mungesës së organizatës së punëdhënësve, 2 anëtarë nga punëdhënësit më të mëdhenj dhe një nga punëdhënësit privatë); 3 anëtarë të sindikatave të mëdha nga numri i anëtarëve të tyre. Përfaqësuesit e punëdhënësve caktohen për periudhën e tranzicionit, deri në formimin e organizatave të punëdhënësve, nga drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur drejtorët e ndërmarrjeve të mëdha. Emërimi është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Neni 14

Këshilli administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe 2 nënkryetarët, të cilët drejtojnë veprimtarinë e këshillit.

Kryetari zgjidhet nga 6 përfaqësuesit e ministrive, kurse 2 zëvendëskryetarët një nga sindikatat dhe një nga punëdhënësit.

Neni 15

Këshilli administrativ mblidhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 16

Mbledhja e këshillit administrativ thirret nga kryetari, nga dy nënkryetarët e tij dhe nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së. Ky i fundit ka të drejtë të mbledhë këshillin administrativ kur interesat e ISSH-së kërkojnë vendime të shpejta, që nuk janë në kompetencë të tij.

Neni 17

Mbledhja e këshillit administrativ njoftohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Kur mbledhja e këshillit administrativ thirret nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, mund të mos zbatohen kriteret e mësipërme.

Neni 18

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të punëdhënësve dhe të sindikatave si anëtarë të këshillit administrativ. Vendimet merren me shumicë votash.

Nëse shumica nuk arrihet, mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke bërë edhe njëherë njoftimin e pjesëmarrësve. Për mbledhjen e përsëritur do të jetë e nevojshme gjysma e anëtarëve, duke përfshirë një përfaqësues nga punëdhënësit dhe një nga sindikata. Megjithatë, vendimet merren vetëm me dy të tretat e votave.

Neni 19

Për mbledhjet e këshillit administrativ mbahet procesverbal. Kryetari autorizon një person të përhershëm për mbajtjen e tij.

Vendimet e këshillit administrativ nënshkruhen nga kryetari, ose një nga nënkryetarët dhe depozitohen në drejtorinë e ISSH-së.

Neni 20

Vendimet e këshillit merren me shumicë absolute votash.

Anëtari i këshillit administrativ ka të drejtën e një vote.

Në rastet kur votat barazohen, vendos vota e kryetarit të këshillit administrativ.

Neni 21

Kompetencat e këshillit administrativ:

a) Zgjedh drejtorin e përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

b) Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore.

c) Vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me investimet e fondeve.

ç) I propozon Ministrit të Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale për ndryshimet në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin për sigurimet shoqërore.

d) Vendos për lidhjen e marrëveshjeve e të kontratave të rëndësishme.

dh) Miraton komisionin e kontrollit për kontrollin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

e) Miraton rregulloret, të propozuara nga drejtori i përgjithshëm, që kanë të bëjnë me çështjet financiare.

Neni 22

Anëtarët e këshillit administrativ hiqen nga detyra, kur:
a) dënohen për vepra penale;
b) japin dorëheqjen;
c) marrin pjesë ose ndihmojnë në korrupsion;
ç) janë të paaftë për kryerjen e detyrës.

Neni 23

Anëtarët e këshillit administrativ të ISSH marrin një shpërblim për pjesëmarrje, masa e të cilit caktohet nga vetë këshilli administrativ.

Neni 24

Drejtori i përgjithshëm i ISSH-së zgjidhet nga këshilli administrativ i ISSH-së.

Ai përfaqëson ISSH-në dhe drejton veprimtarinë e tij.

Përgjigjet për administrimin dhe raporton çdo vit për veprimtarinë e ISSH-së në këshillin administrativ.

Emëron trupin drejtues si organ këshillues të drejtorit.

Neni 25

Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm:

a) Miraton rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, kur është ngarkuar nga ligji.

b) Përcakton rregullat e brendshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

c) Përcakton dhe miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

ç) Emëron punonjësit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe drejtorët e drejtorive në rrethe, si dhe përcakton pagat e tyre.

d) Vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda kufijve të planit financiar të tij.

dh) Vendos për të gjitha çështjet për administrimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe raporton para këshillit administrativ për punën e tij.

e) Propozon në këshillin administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar për 3 vjet dhe rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me kontribucionet dhe problemet financiare.

Neni 26

Në ISSH krijohet trupi drejtues, i përbërë nga zëvendësdrejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive.

Trupi drejtues është organ këshillimor i drejtorit.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

ISSH ka të drejtë të lëshojë udhëzime, urdhëresa dhe akte të tjera administrative, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave që janë dhënë.

Neni 28

ISSH ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me organizatat joqeveritare ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore.

Neni 29

ISSH ka të drejtën e depozitimit, të përdorimit dhe investimit të mjeteve të tij financiare në bazë të ligjit, rregullores financiare dhe vendimeve të këshillit administrativ.

Neni 30

Nga veprimtaria e ISSH-së caktohet një fond në lekë e në valutë që përdoret për pagesat e kuotacionit të anëtarësisë në ISSA për seminare, kurse e specializime brenda e jashtë vendit, si dhe për pajisje për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh të huaj, madhësia e të cilave caktohet nga këshilli administrativ.

Neni 31

ISSH ka stemën dhe vulën e tij me shenjat e stemës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 32

Për problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut, rregullimi do të bëhet me vendim të këshillit administrativ, brenda kompetencave që lejojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 33

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave dhe i shtrin efektet që nga data e krijimit të ISSH-së.

VENDIM
Nr.1022, datë 9.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.161, DATË 11.4.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 78 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.161, datë 11.4.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I “Krijimi dhe vendi”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, i pavarur. Organizimi dhe funksionimi i këtij instituti, që më poshtë do të quhet ISSH, rregullohen me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

ISSH-ja është person juridik, shqiptar, me qendër në Tiranë, dhe përbëhet nga drejtoria qendrore, drejtoritë rajonale dhe agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore, që veprojnë në të gjithë vendin.”.

2. Në kreun II “Fondet themelore, burimet e formimit dhe përdorimi i tyre”, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Fondi i ISSH-së administrohet në pesë degë të veçanta:

- Dega e sigurimit për sëmundje;
- Dega e sigurimit për barrëlindje;
- Dega e sigurimit për pensione;
- Dega e sigurimit për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;
- Dega e sigurimit të papunësisë.

Llogaria e sigurimeve shoqërore mbahet në Bankën e Shqipërisë, ndërsa llogaria e shpenzimeve administrative mbahet në llogari të veçantë.

Transferimet për pagesën e kontributeve e të shpenzimeve administrative lejohen vetëm me ligjin e buxhetit.”.

b) Në fund të nenit 5 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“ISSH-ja krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave, që nevojiten për të përballuar, të paktën 3 muaj, shpenzimet për pensione.

Fondi rezervë mbahet në një llogari të veçantë.”.

3. Në kreun III “Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 6

Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore përfshin:

i) arkëtimin e detyrimeve, që rrjedhin nga derdhja e kontributit të punëmarrësve, punëdhënësve dhe të të vetëpunësuarve;

ii) pagimin e përfitimeve të sigurimeve, sipas dispozitave ligjore;

iii) investimin e fondit rezervë, me qëllimin rritjen e tij.”.

b) Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet drejtorive rajonale dhe agjencive lokale, kryen veprime për sigurimin shoqëror.

Drejtoritë rajonale caktojnë pensionet, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga personat e interesuar.

Përfitimet afatshkurtra për të punësuarit caktohen dhe paguhen nga punëdhënësit e tyre dhe, pas miratimit, rimbursohen nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Përfitimet afatshkurtra për të vetëpunësuarit dhe pensionet e të gjitha llojeve paguhen nga agjencitë paguese financiare, të specializuara, për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, sipas marrëveshjeve, që lidhen, ku përcaktohet edhe masa e komisionit.”.

4. Në kreun IV “Kontabiliteti dhe bilanci i ISSH-së”, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

ISSH-ja mban regjistrat dhe librat, në përputhje me ligjin për kontabilitetin, manualin kontabël, miratuar nga Ministria e Financave, si dhe rregulloren financiare, miratuar nga këshilli administrativ.”.

b) Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

ISSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton projektbuxhetin e vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga këshilli administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten, çdo vit, nëpërmjet Ministrit të Financave, Këshillit të Ministrave.”.

c) Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

1. Këshilli administrativ, pas miratimit të buxhetit, miraton ndarjen e buxhetit, sipas drejtorive rajonale.

2. Në përbërje të ISSH-së ngrihet njësia e auditimit të brendshëm, e cila auditon veprimtarinë e strukturave të saj jo më pak se një herë në dy vjet. Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm emërohet/shkarkohet me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me miratimin e këshillit administrativ. Drejtuesi i njësisë raporton periodikisht dhe sipas kërkesave të këshillit.”.

5. Nenet 13, 21, 24, paragrafi i fundit, 25 e 26, të kreut V, shfuqizohen.

6. Neni 28 i kreut “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 28

ISSH-ja ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore. Marrëveshjet me karakter ekonomik, para nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm, si përfaqësues i ISSH-së, i paraqiten, paraprakisht, këshillit administrativ, për miratim.

Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me institucione homologe, vendase ose të huaja, në fushën e sigurimeve shoqërore, vetëm pas miratimit të këshillit administrativ.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 25.7.2008

VENDIM
Nr. 788, datë 14.12.2005

PËR PËRCAKTIMIN E AKSIDENTIT NË PUNË OSE PËR SHKAK TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aksident në punë ose për shkak të punës është dëmtimi i menjëhershëm trupor, i ndodhur gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi, që ka lidhje me punën, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje të përgjithshme, por që sjell paaftësi, të përkohshme ose të përhershme, në punë ose vdekje.

2. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur personi i punësuar dëmtohet:

a) gjatë kryerjes së punës së zakonshme;

b) gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por, për arsye madhore, në interes të punës;

c) gjatë kreyrejs së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;

ç) gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;

d) gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësit dhe kur ai është individual.

3. Në çdo rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, duhet të lajmërojë, brenda 3 ditëve, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Në rast të një aksidenti në punë ose për shkak të punës, me pasojë vdekje apo dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale, për analizën e këtij aksidenti, dhe të lajmërojë, menjëherë, organet e prokurorisë, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Kur aksidenti ka ndodhur gjatë rrugës nga banesa për në punë dhe anasjelltas, procesverbali i mbajtur nga organet e policisë, duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit, për përfitimin e pagesës së aksidentit në punë.

6. Aksidenti në punë ose për shkak të punës vërtetohet me procesverbalin e mbajtur në vendin e ngjarjes dhe duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga inspektori i punës, brenda tri ditëve nga ndodhja e aksidentit.

Forma e procesverbalit dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij përcaktohen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Për shkeljet sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, punëdhënësi ose personi përgjegjës i ngarkuar prej tij, dënohen sipas kreut VIII "Procedura dhe sanksione" të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", të ndryshuar.

8. Vendimi nr.460, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave "Për aksidentet në punë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, datë 23.12.2005

VENDIM
Nr.396, datë 28.6.2007

PËR PËRCAKTIMIN E SËMUNDJEVE PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sëmundje profesionale është çdo sëmundje e shkaktuar si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve, që rrjedhin nga veprimtaria e punës.
2. Caktimi i shkallës së humbjes së aftësisë për punë, shkaktuar nga sëmundje profesionale, është vetjak dhe bazohet në studimin morfo-funksional të individit, në kushtet e punës.
3. Sëmundjet profesionale përcaktohen sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Sëmundjet profesionale, deklarohen në mënyrë të detyrueshme, nga shërbimi shëndetësor, shtetëror dhe privat, nëpërmjet fletëdeklarimit të sëmundjeve profesionale, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.83, datë 6.7.2007

LISTA E SËMUNDJEVE PROFESIONALE

1. Sëmundje të shkaktuara nga agjentët
1.1 Sëmundje të shkaktuara nga agjentët kimikë
1.1.1 Sëmundje të shkaktuara nga beriliumi ose përbërësit e tij toksikë
1.1.2 Sëmundje të shkaktuara nga kandmiumi ose përbërësit e tij toksikë
1.1.3 Sëmundje të shkaktuara nga fosfori ose përbërësit e tij toksikë
1.1.4 Sëmundje të shkaktuara nga kromi ose përbërësit e tij toksikë
1.1.5 Sëmundje të shkaktuara nga manganezi ose përbërësit e tij toksikë
1.1.6 Sëmundje të shkaktuara nga arseniku ose përbërësit e tij toksikë
1.1.7 Sëmundje të shkaktuara nga mërkuri ose përbërësit e tij toksikë
1.1.8 Sëmundje të shkaktuara nga plumbi ose përbërësit e tij toksikë
1.1.9 Sëmundje të shkaktuara nga fluori ose përbërësit e tij toksikë
1.1.10 Sëmundje të shkaktuara nga sulfuri i karbonit
1.1.11 Sëmundje të shkaktuara nga derivatet e halogjenuara toksikë të hidrokarbureve alifatike ose aromatike
1.1.12 Sëmundje të shkaktuara nga benzeni ose homologët e tij toksikë
1.1.13 Sëmundje të shkaktuara nga derivatet toksike nitro dhe amino të benzenit ose homologë të tij
1.1.14 Sëmundje të shkaktuara nga nitroglicerina ose nga esteret acido nitrike
1.1.15 Sëmundje të shkaktuara nga alokolet, glikolet ose ketonet
1.1.16 Sëmundje të shkaktuara nga substanca asfiksuese: oksidi i karbonit, acidi cianhidrik ose derivatet e tij toksike, hidrogjeni i sulfuruar

1.1.17 Sëmundje të shkaktuara nga akrilonitrili

1.1.18 Sëmundje të shkaktuara nga oksidet e azotit

1.1.19 Sëmundje të shkaktuara nga vanadiumi ose përbërësit e tij toksikë

1.1.20 Sëmundje të shkaktuara nga antimoni ose përbërësit e tij toksikë

1.1.21 Sëmundje të shkaktuara nga hekzani

1.1.22 Sëmundje të shkaktuara nga acidet minerale

1.1.23 Sëmundje të shkaktuara nga agjentët farmaceutikë

1.1.24 Sëmundje të shkaktuara nga taliumi ose përbërësit e tij

1.1.25 Sëmundje të shkaktuara nga osmiumi ose përbërësit e tij

1.1.26 Sëmundje të shkaktuara nga seleniumi ose përbërsit e tij

1.1.27 Sëmundje të shkaktuara nga bakri ose përbërësit e tij

1.1.28 Sëmundje të shkaktuara nga kallai dhe përbërësit e tij

1.1.29 Sëmundje të shkaktuara nga zinku ose përbërësit e tij

1.1.30 Sëmundje të shkaktuara nga ozoni, fosgeni

1.1.31 Sëmundje të shkaktuara nga substanca irrituese, benzokinone dhe irritues të tjerë të kornesë

6. Rregullat e veçanta të përfitimit të pagesës dhe të zbatimit të skemës së kompensimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.25, datë 29.8.2007

VENDIM
Nr.763, datë 27.11.2006

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë, të të ardhurave mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që në datë 30.11.2006 janë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të

Ministrave "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm" dhe nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve".

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.12.2006 kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t'u shtohet shuma deri në 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet, duke shumëzuar masën e plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c" e "ç" të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.12.2006 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 154 766 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2006.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.12.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.126, datë 30.11.2006

VENDIM
Nr.17, datë 20.1.2007

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE TË FSHATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për

pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që në datë 31.12.2006 janë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, të kompensohen deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, në të ardhurat mujore të pensionistit që merr pension fshati përfshihen:

a) Për pensionistin që banon në fshat, masa e pensionit të pleqërisë, të pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse".

b) Për pensionistin që banon në qytet, masa e pensionit të pleqërisë, e pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", dhe kompensimi, që jepet në përputhje me vendimin nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", për pensionistët e qytetit.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.1.2007 kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t'u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c" e "ç" të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.1.2007 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, në shumën 1 344 milion lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore i miratuar për vitin 2007.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, datë 20.1.2007

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E PENSIONEVE

VENDIM
Nr.27 datë 15.1.1993

PËR RRITJEN E MASËS SË PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të rriten pensionet dhe ndihmat që përfitohen nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 "Për Sigurimet Shoqërore", në masën 25 për qind.

2. Kufijtë e masës së pensioneve, të ndihmave dhe të pagave kufi që parashikohen nga ligji nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për Sigurimet Shoqërore", të ndryshohen si vijon:

- Në nenin 17, paragrafi i fundit, masa e pensionit bëhet 1075 lekë në muaj.
- Në nenin 17-a, paragrafi i dytë, pensioni për vjetërsi shërbimi në raste të veçanta nuk mund të jetë më i ulët se 1075 lekë në muaj dhe më i lartë se 1465 lekë në muaj.
- Në nenin 17-b, paragrafi i fundit, pensioni i parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se 1710 lekë në muaj.
- Në nenin 19-a, masa e ndihmës bëhet 490 lekë në muaj.
- Në nenin 20, paragrafi i dytë, pensioni i pleqërisë nuk mund të jetë më i ulët se 1075 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1710 lekë në muaj.
- Në nenin 20-a, paragrafi i tretë, kufiri i pagës bëhet 2195 lekë në muaj.
- Në nenin 24, paragrafi i tretë, pensioni i invaliditetit nuk mund të jetë më i ulët se 1370 lekë për grupin e parë, 1210 lekë për grupin e dytë, 1115 lekë për grupin e tretë dhe 485 lekë për grupin e katërt dhe as më i lartë se 1775 lekë për grupin e parë dhe të dytë, 1520 lekë për grupin e tretë dhe 890 lekë në muaj për grupin e katërt.
- Në nenin 25, paragrafi i parë, personat që përmenden në shkronjat "c", “ç” dhe "d" të nenit 21 të ligjit, kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe bëhen invalidë, marrin pension invaliditeti mujor në këto masa:

Grupi I 1.145 lekë
Grupi II 890 lekë
Grupi III 735 lekë
Grupi IV 320 lekë

- Në nenin 31, paragrafi i dytë, pensioni familjar nuk mund të jetë më i ulët se 1165 lekë në muaj për familje me tre ose më shumë anëtarë, 860 lekë për familje me dy anëtarë dhe 675 lekë për familje me një anëtar dhe as më i lartë se 1710 lekë në muaj për familje me tre ose më shumë anëtarë, 1220 lekë për familje me dy anëtarë dhe 835 lekë për familje me një anëtar.
- Në nenin 32, paragrafi i parë, anëtarët e familjes të personave që përmenden në shkronjat "c", "ç" dhe "d" të nenit 21 të ligjit kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe mbajtësi i familjes vdes, marrin pension familjar mujor në masën që vijon:

Për familje me tre ose më shumë anëtarë	975 lekë
Për familje me dy anëtarë	795 lekë
Për familje me një anëtar	550 lekë

- Në nenin 40, paragrafi i dytë, paga kufi bëhet 2.195 lekë në muaj. Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, pensioni për vjetërsi shërbimi 25 vjet e lartë për burrin dhe 20 vjet e lartë për gruan nuk mund të jetë më i ulet se 1075 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1465 lekë në muaj.
- Në nenin 45, paragrafi i parë, masa e pensionit bëhet 1710 lekë në muaj.

3. Organet e Sigurimeve Shoqërore të bëjnë rritjen e masës së pensioneve (pa përfshirë kompensimin e veshmbathjes, shpërblimin për pjesëmarrjen në Luftën Nacionalçlirimtare dhe

kompensimin për frymë nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë) në masën e parashikuar në këtë vendim për pensionet e caktuara dhe ato me datë fillimi para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Për pensionet që caktohen nga ligji "Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore" me datë fillimi 1 shkurt 1993 e në vazhdim, të ardhurat për efekt të llogaritjes së masës së pensionit të periudhës para 1 shkurtit 1993 rriten 25 për qind.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në planin e shpenzimeve të gjashtëmujorit të parë i shtohen 300 milionë lekë dhe 690 milionë lekë për gjithë vitin 1993.

6. Për të përballuar vëllimin e punës për ndryshimin e masës së pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1993 i shtohen 900 mije lekë fond page.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 shkurt 1993.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 28.2.1993

VENDIM
Nr.345, datë 12.6.1993

PËR RRITJEN E PENSIONEVE, TË PËRKRAHJES SOCIALE DHE TË NDIHMAVE EKONOMIKE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për pensionet:

Të rriten pensionet dhe ndihmat që përfitohen nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", në masën 15 për qind.

2. Kufijtë e masës së pensioneve, të ndihmave dhe të pagave kufi, të parashikuara në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", ndryshohen si vijon:

- Në nenin 17, paragrafi i fundit, masa e pensionit bëhet 1237 lekë në muaj.
- Në nenin 17/a, paragrafi i dytë, pensioni për vjetërsi shërbimi për raste të veçanta nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe më i lartë se 1685 lekë në muaj.
- Në nenin 17/b paragrafi i fundit, pensioni i parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se 1967 lekë në muaj.
- Në nenin 19/a, masa e ndihmës bëhet 564 lekë në muaj.
- Në nenin 20, paragrafi i dytë, pensioni i pleqërisë nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1967 lekë në muaj.
- Në nenin 20/a, paragrafi i tretë, kufiri i pagës bëhet 2525 lekë në muaj.
- Në nenin 24, paragrafi i tretë, pensioni i invaliditetit nuk mund të jetë më i ulët se 1576 lekë për grupin e parë, 1392 lekë për grupin e dytë, 1283 lekë për grupin e tretë dhe 558 lekë për grupin e katërt dhe as më i lartë se 2042 lekë për grupin e parë dhe të dytë, 1748 lekë për grupin e tretë dhe 1024 lekë në muaj për grupin e katërt.
- Në nenin 25, paragrafi i parë, personat që përmenden në shkronjat "c" "ç" dhe "d" të nenit 21 të ligjit, kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe bëhen invalidë, marrin pension invaliditeti mujor në këto masa:

Grupi I……1317 lekë
Grupi II……1024 lekë
Grupi III…… 864 lekë
Grupi IV…… 368 lekë

- Në nenin 31, paragrafi i dytë, pensioni familjar nuk mund të jetë më i ulët si 1340 lekë për familje me tre ose më shumë anëtarë, 989 lekë për familje me dy anëtarë dhe 777 lekë në muaj për familje me një anëtar dhe as më i lartë se 1967 lekë për familje me tre ose më shumë anëtarë, 1403 lekë për familje me dy anëtarë dhe 961 lekë në muaj për familje me një anëtar.

- Në nenin 32, paragrafi i parë, anëtarët e familjes të personave që përmenden në shkronjat "c", "ç" dhe "d" të nenit 21 të ligjit, kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe mbajtësi i familjes vdes, marrin pension familjar mujor në masën që vijon:

Për familje me 3 ose më shumë anëtarë……1122 lekë
Për familje me dy anëtarë…… 915 lekë
Për familje me një anëtar…… 633 lekë

Në nenin 40, paragrafi i dytë, paga kufi bëhet 2525 lekë në muaj. Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, pensioni për vjetërsi shërbimi 25 vjet e lart për burrin dhe 20 vjet e lart për gruan nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1685 lekë në muaj.

- Në nenin 45, paragrafi i parë, masa e pensionit bëhet 1967 lekë në muaj.

3. Për rritjen e përkrahjes sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike:

a) Personave që trajtohen me përkrahje sociale gjer më 30.6.1993, u rritet pagesa për përkrahje sociale në masën 10 për qind mbi atë ekzistuese.

b) Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409, datë 12.11.1991 "Për përkrahjen sociale të personave që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", në pikën 8 paga minimale mujore bëhet 1090 lekë.

4. Në vendimin nr.59, datë 18.3.1983 "Për trajtimin e të huajve që strehoen në Republikën e Shqipërisë", në pikën 3, në paragrafet 1 dhe 2 masa e ndihmës së përhershme mujore bëhet 1140 lekë dhe në paragrafin 5 masa e ndihmës bëhet 1520 lekë.

5. Qendrat e pagesës së pensioneve të llogaritin rritjen e pensioneve (pa përfshirë kompensimin e veshmbathjes, shpërblimin mbi pension për Luftën Nacionalçlirimtare dhe kompensimin për frymë nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë) në masën e parashikuar në këtë vendim dhe të kryejnë pagesat.

6. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 1993. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të bëjë detajimin e këtyre efekteve sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet ekonomike shtrihen nga data 1 gusht 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, datë 30.10.1993

VENDIM
Nr.605, datë 31.12.1993

PËR RRITJEN E PENSIONEVE DHE TË TË ARDHURAVE NGA PAPUNËSIA

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Të rriten në masën 15 për qind të gjitha llojet e pensioneve të përfituara nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë” dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Të rriten në masën 15 për qind të ardhurat nga papunësia, të përfituara na ligji nr.7521, datë 30.10.1991 "Për përkrahjen sociale për personat që dalin nga zbatimi i reformës ekonomike", si dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë".

Shtesën prej 15 për qind e përfitojnë edhe personat që u ka lindur e drejta për pension dhe të ardhura nga papunësia para datës 31.12.1993.

Nuk përfitojnë rritje pensioni personat që sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966.

2. Pensionit dhe të ardhurave nga papunësia, të rillogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi , u shtohet vlefta prej 494 lekësh e kompensimeve të përfituara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.30, datë 24.7.1992 "Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë", dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993 "Për kompensimin për frymmë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës".

Pensionit për vjetërsi shërbimi (sipas nenit 20/a dhe 40 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, i ndryshuar) dhe pensionit të invaliditetit pas rillogaritjes nuk i shtohet vlefta e kompensimeve prej 494 lekësh, në qoftë se personi që e gëzon atë është në marrëdhinie pune ose merr të ardhura nga papunësia.

3. Pensionit të përfituar nga ligji nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", i shtohet vetëm vlefta e kompensimeve prej 494 lekësh, në qoftë se personi që e gëzon atë është me banim të përhershëm në qytet ose qendra të banuara (vërtetuar nga organet e pushtetit lokal).

4. Për zbatimin e këtij vendimi

- Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale, si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ngarkohen të nxjerrin udhëzime përkatëse.

- Organikës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 200 persona me fond page 9.2 milionë lekë.

5. Efektet financiare të parashikohen në projektbuxhetin e vitit 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 28.2.1994

VENDIM
Nr.461, datë 3.10.1994

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe ato që do të caktohen, me datë fillimi deri më 31.12.1994 (përfshirë edhe këtë datë) të ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, të parakohshëm, për vjetërsi shërbimi, për vjetërsi shërbimi për raste të veçanta, për merita të veçanta, invaliditet të grupit I, II dhe III ose invaliditet të plotë që janë ndërmjet kufirit 1920-2050 lekë në muaj, bëhen 2200 lekë në muaj.

b) Pensionet 2051 lekë e lartë shtohen me 150 lekë në muaj.

c) Pensionet e mësipërme, kur janë nën kufirin 1920 lekë në muaj, shtohen me shumën 280 lekë në muaj.

ç) Pensionet familjarë dhe pensionet e invaliditetit të grupit IV ose invaliditetit të pjesshëm rriten në masën 15 për qind.

2. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", dhe nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe ato që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1994, ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, invaliditetit të grupit I dhe II që janë në kufinjtë 528-700 lekë në muaj, bëhen 700 lekë në muaj.

b) Pensionet e mësipërme, kur janë nën kufirin 528 lekë në muaj, shtohen me 172 lekë në muaj.

c) Pensionet familjare dhe pensionet e invaliditetit të grupit III rriten në masën 35 për qind.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore të bëjë ndryshimet e mësipërme dhe të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

4. Efektet financiare prej 88.8 milionë lekësh në muaj përballohen nga buxheti i shtetit. Për këtë në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore gjer më 31.12.1994 shtohen 266.4 milionë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.10.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 20.12.1994

VENDIM
Nr.98, datë 21.2.1995

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.461, DATË 3.10.1994 "PËR RRITJEN E PENSIONEVE"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.461, datë 3.10.1994, të bëhen këto shtesa:

- Në shkronjën "b" të pikës 1, pas fjalës "150 lekë në muaj", shtohen fjalët "por të mos kalohet shuma 3840 lekë në muaj".

- Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"Për invalidët e Luftës, përveç rritjes që pëson pensioni i tyre, shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit rritet në masën 150 lekë në muaj".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.10.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.4, datë 28.3.1995

VENDIM
Nr.245, datë 22.5.1995

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish të Përndjekurve Politikë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të rriten 10 për qind të gjitha llojet e pensioneve të përfituara nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë", si dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me masë pensioni deri në 4000 lekë, kurse pensionet me mbi 4000 lekë bëhen me 4400 lekë.

Këtë rritje e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1995, duke përfshirë edhe këtë datë.

2. Rriten në masën 10 për qind edhe:

a) Shtesa mujore mbi pensionin e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

b) Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".

3. Nuk përfitojnë rritje pensioni personat që, sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë".

4. Masa e pensionit maksimal mbetet 4400 lekë në muaj.

5. Efektet financiare mujore për rritjen e pensioneve janë 81 milionë. Për këtë në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore gjer më 31.12.1995 shtohen 650 milionë lekë, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

6. Për të përballuar punën për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 6 milionë lekë, nga të cilët 3 milionë lekë do të përdoren për shpërblimin e punonjësve të përhershëm që do të punojnë mbi kohën normale të punës, dhe 3 milionë lekë fond pagë për aktivizimin e punonjësve të tjerë provizorë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse ngarkohen Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.5.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, datë 10.10.1995

VENDIM
Nr.581, datë 25.10.1995

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohen si vijon:

Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, për merita të veçanta, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare me masë pensioni mujor:

- deri në 2420 lekë, rriten 12 për qind;
- nga 2421 lekë deri në 2510 lekë, bëhen 2710 lekë;
- nga 2511 lekë deri në 4074 lekë, rriten 8 për qind;
- nga 4075 lekë deri në 4400 lekë, bëhen 4400 lekë.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, me datë fillimi nga 1 tetori 1995 e në vazhdim, nuk mund të caktohet më pak se 2710 lekë në muaj. Pensioni maksimal mbetet 4400 lekë në muaj. Kufiri maksimal për pensione shtetërore të posaçme mbetet 8800 lekë në muaj.

2. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 10 për qind.

3. Shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit për invalidët e luftës, e përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rritet në masën 8 për qind.

4. Pensionet e caktuara në bazë të nenit 40 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 nuk do të kenë kufi në lidhje me pagesën, kur përfituesi punon në sektorin privat, kurse për ata që punojnë në sektorin shtetëror, të ardhurat (paga + pension) nuk duhet të kalojnë pagën e sotme analoge me atë të funksionit që ata kanë pasur kur kanë përfituar pension.

5. Nuk përfitojnë rritje pensioni personat, pensioni i të cilëve është caktuar sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe personat që sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit të përcaktuar nga paragrafi i parë, pika II, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 23.1.1995.

6. Efektet financiare mujore nga rritja e pensioneve janë 90 milionë lekë. Për këtë, në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, deri më 31.12.1995, shtohen 270 milionë lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

7. Për të përballuar punën për rritjen e pensioneve, shpenzimet për shtypshkrime dhe komisionet e bankave; në planin e shpenzimeve administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1995, shtohen 10 milionë lekë, nga të cilat, fond page për shpërblimin e punonjësve dhe punonjësve provizorë, 4 milionë lekë. Shuma prej 10 milionë lekësh përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

8. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.10.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.69, datë 24.9.2010

VENDIM
Nr.229, datë 1.4.1996

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore" dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi me masë pensioni mujor:

- deri në 2600 lekë, rriten 25 për qind;
- nga 2601 lekë deri në 2826 lekë, bëhen 3250 lekë;
- mbi 2827 lekë rriten 15 për qind.

b) Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 20 për qind.

c) Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 20 për qind.

ç) Rritet në masën 15 për qind shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

2. Përfitojnë rritje pensioni në masën 25 për qind personat, të cilëve pensioni u është caktuar sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", si dhe personat që pensioni u është caktuar sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

3. Rritjen në masat e caktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1996, duke përfshirë edhe këtë datë.

- Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit i llogaritur sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi 1.4.1996, nuk mund të caktohet më pak se 3250 lekë në muaj. Masa e pensionit maksimal mbetet 5420 lekë në muaj.
- Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, i llogaritur sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 dhe nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi nga 1.4.1996, nuk mund të caktohen më pak se 875 lekë në muaj.

4. Efektet financiare për vitin 1996 nga rritja e pensioneve janë 1.680 milionë lekë dhe përballohen:

- nga fondet e programuara në planin e vitit 1996 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, 1.460 milionë lekë;
- nga fondet rezervë të Këshillit të Ministrave, 220 milionë lekë.

5. Për përballimin e vëllimit të punës për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 6 milionë lekë fond page, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga 1.4.1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.69, datë 24.9.2010

VENDIM
Nr.67, datë 30.1.1998

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 96, paragrafi i parafundit i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohet si vijon:

Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi me masë pensioni mujor:

- deri në 3250 lekë, rriten 23 për qind;
- nga 3250 lekë deri në 3335 lekë, bëhen 4000 lekë;
- nga 3336 lekë deri 3970 lekë, rriten 20 për qind;
- nga 3971 lekë deri 4070, bëhen 4765 lekë;
- mbi 4071 lekë, rriten 17 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 23 për qind.

Pensionet shtetërore të posaçme rriten në masën 17 për qind.

Shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", rritet në masën 17 për qind.

Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.1.1998, duke përfshirë edhe këtë datë.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, me datë fillimi nga 1.2.1998 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 3997 lekë në muaj.

II. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 20 për qind.

III. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", rriten në masën 20 për qind.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit që caktohen sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi nga 1.2.1998 e në vazhdim nuk mund të llogariten më pak se 1050 lekë në muaj.

IV. Efektet financiare nga rritja e pensioneve janë 2658 milionë lekë dhe do të përballohen nga fondet e programuara në Buxhetin e Shtetit në vitin 1998.

V. Për përballimin e volumit të punës për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 4.5 milionë lekë fond page, të cilat përballohen nga fondet për shpenzime administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1998.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse ngarkohen ISSH-ja dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga 1.2.1998.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.69, datë 24.9.2010

VENDIM
Nr.826, datë 30.12.1998

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës e Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të paragrafit të dytë, të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, ndryshohen si vijon:

"Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind."

2. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë dhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.3.1999, duke përfshirë edhe këtë datë.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim nuk mund të caktohen më pak se 4400 lekë në muaj. Pensioni maksimal mbetet 8000 lekë në muaj.

3. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", rritet në masën 10 për qind.

4. Pensionet e pleqërisë të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", rriten në masën 15 për qind.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar që caktohen sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë, të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998 me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 1155 lekë në muaj.

5. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr. 758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" rriten në masën 10 për qind.

6. Efektet financiare nga rritja e pensioneve llogariten në shumën 154.8 milionë lekë në muaj dhe të përballohen nga fondi i Sigurimeve Shoqërore të programuara në buxhetin e vitit 1999.

7. Për përballimin e volumit të punës për rritjen e pensioneve dhe për prodhimin e urdhër pagesave të reja, Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përdorë 4.5 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1999.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në bazë dhe për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra Maj 2000

VENDIM
Nr.290, datë 10.6.1999

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.826, DATË 30.12.1998 "PËR RRITJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të cilat nuk kanë përfituar rritje të plotë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", për shkak të kufizimit nga niveli maksimal i pensionit, do të përfitojnë diferencat nga data 1.4.1999.
2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", në pikën 2 paragrafi 2 hiqet fjalia "Pensioni maksimal mbetet 8 000 (tetë mijë) lekë."
3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondi i degës së pensioneve, i programuar në buxhetin e vitit 1999 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, datë 26.7.1999

VENDIM
Nr.387, datë 14.7.2000

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë“ dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë“ (i ndryshuar), me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 96, paragrafi i katërt i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshon si vijon:

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, me masë pensioni mujor:

- deri në 4 400 lekë rriten 17 për qind.
- nga 4 401 lekë deri në 4 556 lekë bëhen 5 148 lekë.
- nga 4 557 lekë deri në 5 242 lekë rriten 13 për qind.
- nga 5 243 lekë deri në 5 385 lekë bëhen 5 923 lekë.
- mbi 5 386 lekë e lart rriten 10 për qind.

3. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind.

4. Pensionet shtetërore të posaçme dhe shtesa e pensioneve të posaçme shtetërore rriten në masën 10 për qind.

5. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", rriten në masën 10 për qind.

6. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen, duke filluar nga data 30.6.2000 duke përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5 148 lekë në muaj.

8. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" rriten në masën 15 për qind.

9. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara, sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, (i ndryshuar), rriten në masën 15 për qind.

10. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, që caktohet sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, duke filuar nga data 1.7.2000 e në vazhdim nuk llogariten më pak se 1 328 lekë në muaj.

11. Efektet financiare nga rritja e pensioneve janë 1 645 milionë lekë dhe përballohen nga:

- fondi i sigurimeve shoqërore i miratuar në buxhetin e vitit 2000,në shumën 1 043.5 milionë lekë.
- teprica e fondit të sigurimeve shoqërore e vitit 1999 në shumën 226 milionë lekë.
- fondet e planifikuara për koston e ristrukturimit të bankave në shumën 375.5 milionë lekë.

12. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zërin "shpenzime", i shtohen 601.5 milionë lekë.

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

14. Për përballimin e vëllimit të punës, për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen në fondin e pagesës 3 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të tij në vitin 2000.

15. Vendimi i shtrin efektet financiare, nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 19.7.2000

VENDIM
Nr.404, datë 11.6.2001

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet e invaliditetit, pensionet familiare, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703,datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën e Shëipërisë", si dhe pensionet e caktuara sipas pikës 4 të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 30 për qind.

3. Këtë rritje në masat e mësipërme, e përfitojnë dhe pensionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, që do të caktohen pas datës 1.7.2001, kur data e fillimit të pensionit është përpara datës 30.6.2001, duke përfshirë dhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familiar, të caktuara me datë fillimi nga data 1.7.2001 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5560 (pesë mijë e pesë qind e gjashtë dhjetë) lekë në muaj dhe jo më shumë se 11.120 (njëmbëdhjetë mijë e njëqindenjëzet) lekë në muaj për pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, si dhe jo më pak se 1726 (një mijë shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekë në muaj e në vazhdim për pensionet e caktuara sipas pikës 4 të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

5. Shtesa mujore, e përfituar nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar" rritet në masën 8 për qind.

6. Pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve shtetërore, të caktuara sipas nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" rriten në masën 8 për qind.

7. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" rriten në masën 8 për qind.

8. Efektet financiare për vitin 2001, nga rritja e pensioneve arrijnë shumën 1 370 000 000 (një miliardë e treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë) lekë. Kjo shumë të përballohet nga:

a) fondet e sigurimeve shoqërore të programuara në buxhetin e vitit 2001: 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) teprica e fondit të sigurimeve shoqërore për vitin 2000: 290 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë milionë) lekë.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Albapost sh.a. për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

10. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për përballimin e vëllimit të punës për rritjen e pensioneve, t'i shtohen në fondin e pagës 3 000 000 (tre milionë) lekë, të cilat të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, zëri "Shpenzime administrative".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, datë 19.6.2001

VENDIM
Nr. 256, datë 13.6.2002

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetëri shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën e Shqipërisë", si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 25 për qind.

3. Pensionet e invaliditetit, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 20 për qind.

4. Rritjen e pensionit e përfitojnë:

a) Në masën 10 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

b) në masën 25 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

c) në masën 20 për qind, edhe pensionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, të cilat caktohen pas datës 1.7.2002, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë përpara datës 30.6.2002, përfshirë edhe këtë datë;

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, me datë fillimi nga 1.7.2002 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 6 116 lekë në muaj dhe jo më shumë se 12 232 lekë në muaj.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, me datë fillimi 1.7.2002 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 2 158 lekë në muaj.

6. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar" rritet në masën 10 për qind.

7. Pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara sipas nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 10 për qind.

8. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 10 për qind.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga rritja e pensioneve për vitin 2002, llogariten në shumën 1 600 milionë lekë dhe përballohen:

a) nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në 1 524 milion lekë;

b) nga rezultati financiar i vitit 2001, në 76 milionë lekë.

10. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efeket financiare nga data 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.27, datë 21.6.2002

VENDIM
Nr.436, datë 26.6.2003

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara në mbështetje të ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të rriten 10 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe pensionet e caktuara në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të rriten 20 për qind.

3. Pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2003, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2003 përfshirë edhe këtë datë dhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 e këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2003, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datë 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten përkatësisht 10 për qind dhe 20 për qind.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me datë fillimi nga 1.7.2003 e në vazhdim, të mos caktohen më pak se 6728 lekë në muaj dhe më shumë se 13 455 lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me datë fillimi nga 1.7.2003 e në vazhdim, të mos caktohen më pak se 2590 lekë në muaj.

6. Rritja e parashikuar nga ky vendim të zbatohet mbi masën që rezulton nga shuma e pensionit, plus shtesat e dhëna sipas neneve 33, 38, 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

7. Shtesa mujore, e përfituar në mbështetje të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të rritet 10 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", të rriten 10 për qind.

9. Efektet financiare për vitin 2003 llogariten në shumën 1659 milionë lekë dhe të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 11.7.2003

VENDIM
Nr.422, datë 2.7.2004

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rriten në masën 15 për qind.

3. Rritje pensioni përfitojnë:

a) në masën 8 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat të jepen duke filluar nga data 1.7.2004, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë.

b) në masën 15 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat të jepen duke filluar nga data 1.7.2004, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2004 e në vazhdim, të jenë jo më pak se 7 266 lekë në muaj dhe jo më shumë se 14 532 lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuar sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2004, në vazhdim nuk caktohen më pak se 2 980 lekë në muaj.

6. Rritja e pensioneve të parashikuara nga ky vendim të zbatohet mbi masën që rezulton nga shuma e pensionit plus shtesat e dhëna sipas neneve 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

7. Shtesa mujore e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të rritet në masën 8 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994, të rriten në masën 8 për qind.

9. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për vitin 2004 llogariten në shumën 1 552 milionë lekë dhe të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë qëllim në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47, datë 13.7.2004

VENDIM
Nr. 383, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, pensionet për merita të veçanta, pensionet e posaçme shtetërore, shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, të rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rriten në masën 15 për qind.

3. Rritje pensioni përfitojnë:

a) në masën 8 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë;

b) në masën 15 për qind edhe pensionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.6.2005, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 7 850 (shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj dhe jo më shumë se 15 700 (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj.

5. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.6.2005 e në vazhdim, të caktohen jo më pak se 3430 (tre mijë e katërqind e tridhjetë) lekë në muaj.

6. Rritja e pensioneve, e parashikuar nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

7. Shtesa mujore, e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 "Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të rritet në masën 8 për qind.

8. Pensionet e caktuara me dekretin e Presidentit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994 të rriten në masën 8 për qind.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, në shumën 1 968.2 milionë lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

10. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 13.6.2005

VENDIM
Nr.399, datë 21.6.2006

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

2. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

3. Pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

4. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërise, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rriten në masën 20 për qind.

5. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rriten në masën 20 për qind.

6. Rritje pensioni përfitojnë:

a) Pensionet e përmendura në pikat 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht, që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

b) Pensionet e përmendura në pikat 4 e 5 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet që caktohen në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 240 (tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë në muaj dhe jo më shumë se 16 480 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

8. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 4 110 (katër mijë e njëqind e dhjetë) lekë në muaj.

9. Rritja e pensioneve, të parashikuara nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

10. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994, rriten në masën 5 për qind.

11. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 1 470 milionë lekë, të përballohen nga:

- Fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.	927 milionë lekë.
- Fondi i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006"	543 milionë lekë.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 5.7.2006

VENDIM
Nr.448, datë 13.7.2007

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 5 për qind të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994.

2. Rritjen, në masën 10 për qind të:

a) pensioneve, të plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Rritja e pensioneve, e parashikuar në këtë vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

4. Rritje, sipas parashikimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.7.2007 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2007, përfshirë edhe këtë datë.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2007 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 650 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 17 300 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë në muaj.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2007 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 4 520 (katër mijë e pesëqind e njëzet) lekë në muaj.

7. Pensionet, që, pas zbatimit të rritjes sipas pikës 1 të këtij vendimi, rezultojnë të jenë nën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, të kompensohen në masën dhe sipas kritereve, të caktuara në vendimin nr.763, datë 27.11.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve".

Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, kudo në vendimin nr.763, datë 27.11.2006, të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve" data "1.12.2006" zëvendësohet me datën "1.7.2007".

8. Pensionistët, që përfitojnë pensione në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në atë masë, që e kanë përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007 i Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit".

9. Pensionistët, që do të përfitojnë pensione të plota pleqërie, invaliditeti ose familjare, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, nuk mund të kenë të ardhura mujore më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa të ardhurat e përfituesve, që marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë, por jo më shumë se 760 (shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

10. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 915 milionë lekë dhe përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit të vitit 2007, për rritjen e pensioneve.

11. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., përllogariten në shumën 30 milionë lekë dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit, të vitit 2007, për rritjen e pensioneve.

12. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzim për procedurat e zbatimit të unifikuar të këtij vendimi me vendimet nr.763, datë 27.11.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve" dhe nr.17, datë 20.1.2007 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit", të Këshillit të Ministrave.

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.111, datë 17.8.2007

VENDIM
Nr.501, datë 16.8.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.448, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RRITJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.448, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pensioneve", të bëhen këto ndryshime:

1.1. Pika 7 riformulohet, si më poshtë vijon:

"7. Pensionistët, që përfitojnë pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ata të caktuar sipas paragrafit të katërt, të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën 5 për qind, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në atë masë, që e kanë përfituar sipas vendimit nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve".".

1.2. Pika 9 riformulohet, si më poshtë vijon:

"9. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim të:

a) kompensohen, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", pensionistët, që do të përfitojnë pensione të plota pleqërie, invaliditeti ose familjare, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ata të caktuar sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 10 410 lekë.

Ndërsa të ardhurat e pensionistëve, që do të marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion, ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 760 lekë në muaj.

b) kompensohen, sipas kritereve dhe masës së kompensimit, të përcaktuar në vendimin nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit, pensionistët, që do të përfitojnë pensione të plota pleqërie, invaliditeti ose familjare, sipas sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 5 410 lekë. Ndërsa të ardhurat e pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion, ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë, por jo më shumë se 690 lekë në muaj.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga vazhdimi i kompensimit të të ardhurave të pensionistëve, sipas përcaktimeve në këtë vendim, kombinuar me rritjen pensioneve, llogariten në shumën 434 milionë lekë dhe të përballohen nga fondet e programit të mbrojtjes sociale, të caktuara në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për procedurat e zbatimit të unifikuar të këtij vendimi, me vendimet nr.448, datë 13.7.2007 "Për rritjen e pensioneve", nr.763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", dhe nr.17, datë 20.1.2007 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve të fshatit", të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.111, datë 17.8.2007

VENDIM
Nr.856, datë 18.6.2008

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 10 për qind, të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994.

2. Rritjen, në masën 15 për qind, të:

a) pensioneve, të plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) pensioneve, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Rritja e pensioneve, e parashikuar në këtë vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

4. Rritje, sipas parashikimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.7.2008 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2008, përfshirë edhe këtë datë.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në

Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensionave, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2008 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 9515 (nëntë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 19 030 (nëntëmbëdhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2008 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5200 (pesë mijë e dyqind) lekë në muaj.

7. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave në masën e përfituar sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", dhe nr.763, datë 27.11.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve".

8. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 2 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit".

9. Kompensohen:

a) sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", dhe nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", pensionistët që do të përfitojnë pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 11 275 lekë, ndërsa të ardhurat për pensionistët, që do të marrin pension të pjesshëm, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 1260 lekë në muaj;

b) sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", pensionistët, që do të përfitojnë pension të plotë invaliditeti apo familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat e tyre mujore janë deri në 10 775 lekë, ndërsa të ardhurat për invalidët, që do të marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 760 lekë në muaj;

c) sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit", pensionistët që do të përfitojnë pension të plotë pleqërie, invaliditeti ose familjar, sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 6090 lekë, ndërsa të ardhurat për pensionistët, që marrin pension të pjesshëm, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë, por jo më shumë se 690 lekë në muaj.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimin i këtij vendimi, përllogariten në shumën 2 668 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) milionë lekë dhe përballohen nga fondi i

kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, për rritjen e pensioneve.

11. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a. përllogariten në shumën 30 (tridhjetë) milionë lekë dhe do të përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.94, datë 23.6.2008

VENDIM
Nr.415, datë 27.4.2009

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 8 për qind, të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994;

d) shtesës mbi pension, të dhënë në përputhje me nenin 33, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Rritjen, në masën 10 për qind, të pensioneve të plota, të pjesshme dhe të reduktuara të invaliditetit dhe të pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 3.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Rritjen, në masën 10 për qind, të shtesave mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 38 e 39, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të

ndryshuar, dhe me nenin 24, të ligjit nr.4171, datë 3.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

4. Rritjen, në masën 22 për qind, të:

a) pensioneve të plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

5. Rritjen, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 e 4, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.5.2009 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit të jetë deri më 30.4.2009, përfshirë edhe këtë datë.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 10 276 (dhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj dhe më shumë se 20 552 (njëzet mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë në muaj.

7. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 6 344 (gjashtë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

8. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.6.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensioneve të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", dhe nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", të Këshillit të Ministrave.

9. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 4, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit".

10. Pas rritjes së pensionit sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi, kompensohen me:

a) 190 lekë në muaj, pensionistët, që përfitojnë pension të plotë, minimal, pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur të ardhurat mujore nga pensioni dhe nga kompensimet, sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", nr.138, datë 31.3.1994, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", dhe nr.471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", të Këshillit të Ministrave, janë deri në 12 036 (dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë;

b) deri në 190 lekë në muaj, por në përpjesëtim të pensionit individual me pensionin e plotë minimal, pensionistët, që përfitojnë pension të pjesshëm pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur marrin pension të pjesshëm, është deri në 10 275 lekë në muaj. Këta pensionistë do të vazhdojnë të përfitojnë kompensimin e llogaritur sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", nr.138, datë 31.3.1994, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", dhe nr.471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", të Këshillit të Ministrave;

c) deri në 190 lekë në muaj, për pensionistët, që marrin pension pleqërie, në qytet, më të lartë se pensioni minimal, kur masën e pensionit plus kompensimet, sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve", nr.138, datë 31.3.1994, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", dhe nr.471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", të Këshillit të Ministrave, e kanë nga 12 037 deri në 12 226 lekë.

11. Kompensimin deri në 190 lekë në muaj e përfitojnë edhe pensionistët, që do të marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, kur shuma e të ardhurave mujore është deri në 12 226 lekë.

12. Pas rritjes së pensioneve, sipas pikave 1 e 4, të këtij vendimi, dhe zbatimit të kompensimeve, sipas pikave 8, 9 e 10, të këtij vendimi, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të pleqërisë, në qytet, nuk mund të jenë më të vogla se 12 226 lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e plota, në fshat, nuk mund të jenë më pak se 7 234 lekë në muaj.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi e që llogariten në shumën 4 294,5 (katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër presje pesë) milionë lekë, të përballohen nga fondi i kontingjencës, i buxhetit të vitit 2009, caktuar për rritjen e pensioneve.

14. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve, nga Posta Shqiptare sh.a. për 0.75 për qind në muaj, llogariten në shumën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë dhe do të përballohen nga fondi i kontingjencës, caktuar në buxhetin e vitit 2009.

15. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për të nxjerrë udhëzimet teknike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.52, datë 30.4.2009

VENDIM
Nr.474, datë 30.6.2010

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republiken e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 4 për qind të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme të pleqërisë, pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994;

d) shtesës mbi pension, të dhënë në përputhje me nenin 33 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Rritjen në masën 6 për qind të pensioneve të plota, të pjesshme dhe të reduktuara të invaliditetit, të invaliditetit nga aksidente në punë dhe sëmundje profesionale dhe të pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 3.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Rritjen në masën 6 për qind të shtesave mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 38, 39 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

4. Rritjen, në masën 10 për qind të:

a) pensioneve të plota dhe të pjesshme të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të cilat pas kësaj rritjeje nuk mund të jenë më të larta se 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj, që është shuma bazë e pensionit.

5. Rritjen, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1 korrik 2010 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit, të jetë deri më 30 qershor 2010, përfshirë edhe këtë datë.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1 korriku 2010 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 10 690 (dhjetëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 21 380 (njëzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

7. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi nga 1 korriku i vitit 2010 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 6980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj, që është shuma bazë e pensionit.

8. Pensionistët që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve" dhe nr. 415, datë 27.4.2009 " Për rritjen e pensioneve".

9. Pensionistët që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë"; dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit në masën e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.17, datë 20.1.2007 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit".

10. Pas rritjes së pensionit sipas përcaktimeve të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij vendimi, kompensohen me:

a) 200 (dyqind) lekë në muaj, pensionistët që përfitojnë pension të plotë pleqërie minimal, të caktuar sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur të ardhurat mujore nga pensioni dhe nga kompensimet, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.138, datë 31.3.1994 "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", nr.471, datë 15.7.1996 "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", dhe nr. 415, datë 27.4.2009 "Për rritjen e pensioneve", janë deri në 12 640 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë. Pas përfitimit të këtij kompensimi të ardhurat minimale rezultojnë të rritura me 6 për qind;

b) deri në 200 (dyqind) lekë në muaj, por në përpjesëtim të pensionit individual me pensionin e plotë minimal, pensionistët që përfitojnë pension të pjesshëm pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur masa e pensionit të pjesshëm është deri në 10 689 (dhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë në muaj. Këta pensionistë do të vazhdojnë të përfitojnë kompensimin e llogaritur sipas vendimeve të

Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.138, datë 31.3.1994 "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", nr. 471, datë 15.7.1996 "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", dhe nr. 415, datë 27.4.2009 "Për rritjen e pensioneve";

c) deri në 200 (dyqind) lekë në muaj, pensionistët që marrin pension pleqërie qyteti më të lartë se pensioni minimal, kur masën e pensionit pas rritjes plus kompensimet, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.763, datë 27.12.2006 "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", nr.138, datë 31.3.1994 "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", nr.471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm", dhe nr.415, datë 27.4.2009 " Për rritjen e pensioneve", e kanë nga 12 641 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një) deri në shumën 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë në muaj.

11. Kompensimin deri në 200 (dyqind) lekë në muaj e përfitojnë edhe pensionistët që do të marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga 1 korriku i vitit 2010 e në vazhdim, kur shuma e të ardhurave mujore që lidhen me pensionin e plotë është deri në 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë.

12. Pas rritjes së pensioneve sipas pikave 1 e 4 dhe zbatimit të kompensimeve sipas pikave 10 e 11 të këtij vendimi, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të pleqërisë në qytet nuk mund të jenë më të vogla se 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e plota në fshat nuk mund të jenë më pak se 7870 (shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj.

13. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën prej 1912 milionë lekësh dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2010, për rritjen e pensioneve.

14. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a., për 0.75 për qind në muaj, përllogariten në shumën 14 milionë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2010.

15. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për nxjerrjen e udhëzimeve teknike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 1.7.2010

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TË VEÇANTA

VENDIM
Nr.386, datë 14.7.2000

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996,, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", si dhe të nenit 1, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitimet suplementare të ushtarakëve, të atyre që janë caktuar dhe të atyre që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror" (i ndryshuar), rriten në masën 10 për qind.
2. Pensionet familjare, ato që janë caktuar dhe që do të caktohen deri në datën 30.6.2000 (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, rriten në masën 10 për qind.
3. Efektet financiare nga rritja e përfitimeve suplemtare të ushtarakëve llogariten në shumën 41 500 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Efektet financiare, nga rritja e pensioneve familjare të familjeve në ngarkim të pilotëve, që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit, llogariten në shumën 480 mijë lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2000 në zërin "Shpenzime", i shtohen 41 980 mijë lekë.
6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Alba Post sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 19.7.2000

VENDIM
Nr.403, datë 11.06.2001

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE
(Ndryshuar me vendim të KM nr.457, datë 28.06.2001)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8087, datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror" dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 04.02.1999 "Për një trajtim të vacantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrësë gjatë fluturimit". Me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.03.1996, me datë fillimi deri më 30.06.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 përqind.
2. Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.8455, datë 04.02.1999, me datë fillimi deri më 30.06.2001, përfshirë edhe kjo datë, rriten në masën 8 përqind.
3. Efektet financiare për rritjen e përfitimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, janë parashikuar në buxhetin e vitit 2001, për sigurimin suplementar të ushtarakëve dhe llogariten në shumën:

a) 35 483 000 (tridhjetepesë milionë e katërqindetetëdhjetetre mijë) lekë, për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve;

b) 576 000 (pesëqind e shtatëdhjetegjashtë mijë) lekë, për pensionet familjare, të familjeve në ngarkim të pilotëve që kane humbur jetën gjatë fluturimit, në përmbushje të detyrës.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Albapost, sha, për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga 01.07.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, datë 19.6.2001

VENDIM
Nr. 255, datë 13.6.2002

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999 dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999, me datë fillimi deri më 30.6.2002, përfshirë dhe këtë datë, rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", me ndryshimet përkatëse, me datë fillimi deri më 30.6.2002 përfshirë dhe këtë datë, rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare për rritjen e përfitimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe llogariten si më poshtë vijon:

- 48 014 000 (dyzet e tetë milionë e katërmbëdhjetë mijë) lekë për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve;
- 627 000 (gjashtëqind e njëzeteshtatë mijë) lekë për pensionet familjare, të familjeve në ngarkim të pilotëve që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtj vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.27, datë 21.6.2002

VENDIM
Nr.444, datë 26.6.2003

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE DHE TË PENSIONEVE DHËNË FAMILJARËVE TË PILOTËVE TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 dhe 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", si dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 " Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", i ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 10 për qind.

2. Pensionet familjare të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", i ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2003, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 10 për qind.

3. Efektet financiare në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi llogariten në shumën 98.7 milionë lekë dhe janë programuar në buxhetin e vitit 2003, për sigurimin suplementar të ushtarakëve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 11.7.2003

VENDIM
Nr.423, datë 2.7.2004

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE DHE TË PENSIONEVE FAMILJARE TË FAMILJEVE TË PILOTËVE, QË KANË HUMBUR JETËN NË PËRMBUSHJE TË DETYRËS, GJATË FLUTURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2004, përfshirë dhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.
2. Pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004 llogariten në shumën 50 100 000 (pesëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2004, parashikuar për sigurimin suplementar të ushtarakëve.
4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47, datë 13.7.2004

VENDIM
Nr. 71, datë 4.2.2005

PËR RRITJEN E MASËS SË TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE, QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRISË USHTARAKE, DHE TË PILOTËVE FLUTURUES, NË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtrake, të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për punonjësit, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, masa e trajtimit të veçantë, e përfituar sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", rritet 8 për qind.
2. Për pilotët fluturues, në pension, masa e trajtimit të veçantë, e përfituar sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", rritet 8 për qind.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 10.2.2005

VENDIM
Nr. 375, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E TRAJTIMEVE FINANCIARE, TË VEÇANTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të nenit 5 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension", të nenit 8 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake" dhe të nenit 6/1 të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension", me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

3. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

4. Masat e trajtimeve të veçanta, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 13.6.2005

VENDIM
Nr.384, datë 31.5.2005

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare të familjeve të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2005, llogariten në shumën 65 500 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 13.6.2005

VENDIM
Nr.459, datë 21.6.2006

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension", të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" dhe të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, rriten në masën 2 për qind.

2. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues, në pension, rritet në masën 2 për qind.

3. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve të industrisë ushtarake, rritet në masën 5 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension, rritet në masën 2 për qind.

5. Pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invalidetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", rriten në masën 2 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë, rritet në masën 5 për qind.

7. Rritjen në masën 2 për qind, sipas pikave 1, 2, 4 e 5, të këtij vendimi, si dhe rritjen në masën
5 për qind, sipas pikave 3 e 6 të këtij vendimi e përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara, me datë fillimi deri më 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, llogariten në shumën 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë, dhe do të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINJSTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 14.7.2006

VENDIM
Nr.447, datë 13.7.2007

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension", të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare, pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2007, përfshirë dhe kjo datë, të rriten në masën 3 për qind.

2. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të rriten në masën 3 për qind.

3. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues në pension të rritet në masën 3 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension, të rritet në masën 3 për qind.

5. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të rritet në masën 3 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake të rritet në masën 3 për qind.

7. Rritjen, në masën 3 për qind, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi, do ta përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara, me datë fillimi deri në 30.6.2007, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 55 milionë lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, datë 3.8.2007

VENDIM
Nr.820, datë 18.6.2008

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARËKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 " Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension", të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 5 për qind.

2. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të punonjësve të

Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paaftë plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të rriten në masën 5 për qind.

3. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues, në pension, të rritet në masën 5 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension, të rritet në masën 5 për qind.

5. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të rritet në masën 5 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake, të rritet në masën 5 për qind.

7. Rritjen në masën 5 për qind, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 e 6 të këtij vendimi, do ta përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara në vazhdim, por me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 100 (njëqind) milionë lekë, dhe do të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.95, datë 25.6.2008

VENDIM
Nr.416, datë 27.4.2009

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE E TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension", të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake" dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 4 për qind të:

a) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensioneve suplementare të pleqërisë, pensioneve suplementare të invaliditetit, pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, janë bërë plotësisht të paaftë për shërbim, pensioneve suplementare familjare,

pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, dhe pensioneve familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë dhe kjo datë;

b) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensioneve suplementare të pleqërisë, pensioneve suplementare të invaliditetit, pensioneve suplementare të invaliditetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që për shkak të detyrës, janë bërë plotësisht të paaftë për shërbim, pensioneve suplementare familjare dhe pensioneve suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, humbasin jetën, për shkak të detyrës, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë dhe kjo datë;

c) trajtimeve të veçanta financiare të pilotëve fluturues, në pension;

ç) trajtimeve të veçanta financiare të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension;

d) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake.

2. Rritjen në masën 10 për qind të trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë.

3. Rritjen në masën 4 për qind do ta marrin edhe të gjitha përfitimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, kur caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por me datë fillimi deri në 30.4.2009, përfshirë edhe këtë datë.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi e që llogariten në shumën 93 000 000 (nëntëdhjetë e tre milionë) lekë, të përballohen nga fondi i kontingjencës, në buxhetin e vitit 2009, caktuar për rritjen e pensioneve.

5. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.52, datë 30.4.2009

VENDIM
Nr.476, datë 30.6.2010

PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension", të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", dhe të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 4 për qind, të:

a) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të pensioneve suplementare të pleqërisë, të pensioneve suplementare të invaliditetit, të pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve që, për shkak të detyrës, bëhen plotësisht të paaftë për shërbim, të pensioneve suplementare familjare, të pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, të caktuara me ligjin nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", dhe ligjin nr.8661, datë 18.9.2000, "Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", të ndryshuar me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë";

b) trajtimit të veçantë financiar të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar;

c) trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues sipas ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension";

ç) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension";

d) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar;

dh) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake";

e) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.".

2. Rritjen, në masën 4 për qind, do ta marrin edhe të gjitha përfitimet e përcaktuara në pikën 1, kur caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por me datë fillimi të së drejtës deri më 30.6.2010, përfshirë edhe këtë datë.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogariten në shumën 98 420 mijë lekë dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit të vitit 2010, për rritjen e pensioneve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 1.7.2010

VENDIM
Nr.232, datë 10.4.1998

PËR RRITJEN E SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të paragrafit të katërt të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesit nazifashistë të popullit shqiptar" dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 26.4.1996, për shkak të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit në masën 73.78 përqind për periudhën janar 1995 deri në dhjetor 1997, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", ndryshuar me vendimin nr.2, datë 10.1.1996, shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar"", rritet në masën 74 për qind si më poshtë:

- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "a" nga 1500 lekë në muaj, bëhet 2610 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "b" nga 1200 lekë në muaj, bëhet 2088 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "c" nga 1000 lekë në muaj, bëhet 1740 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "e" nga 300 lekë në muaj, bëhet 522 lekë në muaj.
- Shpërblimi prej 500 lekë në muaj sipas pikës 8 dhe 11 bëhet 870 lekë në muaj.
- Shpërblimi i menjëhershëm sipas pikës 13, nga 20 mijë lekë bëhet 34 800 lekë.

2. Rritja e shpërblimit të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, në vartësi të indeksit të çmimeve dhe të inflacionit të bëhet në fillim të çdo viti.

3. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondi i akorduar për këtë qëllim për Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Buxhetin e Shtetit për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra IX, datë 11.4.2003

VENDIM
Nr.109, datë 13.3.1999

PËR RRITJEN E SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të katërt të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", të vendimit të Gjykatës Kushtetues nr.7, datë 26.4.1996 dhe të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.232, datë 10.4.1998, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", ndryshuar me vendimin nr.2, datë 10.2.1996 dhe me vendimin nr.232, datë 10.4.1998", shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar rritet në masën 8,7 për qind si vijon:

- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "a" nga 2 610 lekë në muaj bëhet 2 837 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "b" nga 2 088 lekë në muaj bëhet 2 270 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 7 shkronja "c" nga 1 740 lekë në muaj bëhet 1 891 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 8 dhe 11 nga 870 lekë në muaj bëhet 945 lekë në muaj.
- Shpërblimi i menjëhershëm sipas pikës 13 nga 34 800 lekë bëhet 37 830 lekë

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondi i akorduar për këtë qëllim për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e shtetit për vitin 1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.14, datë 4.5.1999

VENDIM
Nr.217, datë 10.4.2003

PËR RRITJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar"", të bëhen këto ndryshime:

-Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

